

Bashkia Tiranë

Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian

2017-2020



BASHKIMI EUROPIAN



BASHKIA
TIRANË



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETTESISE
DHE MBROJTJES SOCIALE



Institute for Democracy and Mediation



Empowered lives.
Resilient nations.





Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës 2017-2020

Përgatitja e Planit të Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës (2017-2020) u mundësua në kuadër të Projektit “Fuqizimi Ekonomik dhe Social i Romëve dhe Egjiptianëve – një shtysë për përfshirje sociale” (ESERE), financuar nga BE dhe zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri. Procesi planifikues u asistua nga ekspertët e Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në bashkëpunim me Grupin Lokal me Pjesëmarrje të krijuar në Bashkinë e Tiranës përgjatë muajve Dhjetor 2016-Shtator 2017.



Tabela e përmbajtjes

SHKURTIME	8
HYRJE	13
KAPITULLI I. QASJA METODOLOGJIKE	19
Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian	20
Metodologjia	24
Aktorët e përfshirë	24
KAPITULLI II. ANALIZA E SITUATËS AKTUALE	27
Një përmbledhje e situatës aktuale	28
Regjistrimi Civil dhe Aksesi në Sistemin e Drejtësisë	33
Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor	39
Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP)	47
Kujdesi shëndetësor	53
Strehimi dhe integrimi urban	60
Mbrojtja sociale	69

KAPITULLI III. PLANI I VEPRIMIT	77
Vizioni	78
Qëllimet strategjike dhe objektivat	79
Fusha prioritare: Regjistrimi Civil dhe Aksesit në Sistemin e Drejtësisë	80
Fusha prioritare: Arsimit dhe Promovimit i dialogut ndërkulturor	84
Fusha prioritare: Punësimi dhe Arsimit e Formimit Profesional (AFP)	92
Fusha prioritare: Kujdesi shëndetësor	98
Fusha prioritare: Strehimi dhe integrimi urban	102
Fusha prioritare: Mbrojtja sociale	106
KAPITULLI IV. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT	113
ANEKSE	121
Panoramë e përgjithshme e kuadrit ligjor, politikave dhe strategjive për integrimin social dhe ekonomik të komunitetit Rom dhe Egjiptian	122

Shkurtime

AFP	Arsimi e Formimi Profesional
ASHR	Autoriteti Shëndetësor Rajonal, Tiranë
CRCA	Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
DAK	Drejtoria e Artit dhe Kulturës, Bashkia Tiranë
DAR	Drejtoria Arsimore Rajonale, Qytet dhe Qark Tiranë
DF	Drejtoria e Financës
DJ	Drejtoria Juridike, Bashkia Tiranë
DLGJC	Drejtoria e Liçensimit dhe Gjendjes Civile, Bashkia Tiranë
DMPS	Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Bashkia Tiranë
DNP	Drejtoria e Nxitjes së Punësimit, Bashkia Tiranë
DPGJC	Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
DPLASH	Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore e Shëndetësore, Bashkia Tiranë
DPMF	Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar
DPMU	Drejtoria e Pastrimit e Mbetjeve Urbane, Bashkia Tiranë
DPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Bashkia Tiranë
DPPN3	Drejtoria e Përgjithshme e Punetoreve të Qytetit nr.3
DPSHS	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale
DPZHE	Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik, Bashkia Tiranë
DR	Drejtoria e Rinisë, Bashkia Tiranë
DSS	Drejtoria e Strehimit Social, Bashkia Tiranë
DTZH	Drejtoria e Trajnimit dhe Zhvillimit, Bashkia Tiranë

FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, dega Tiranë
IDM	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
INSTAT	Instituti i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KB	Këshilli i Bashkisë, Bashkia Tiranë
KE	Komisioni Evropian
NjA	Njësi Administrative
NjEF	Njësi Ekonomike Familjare
NJMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Tiranë
OCR	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
OSFA	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
PBSHSh	Paketa Bazë e Shërbimeve Shëndetësore
QEZHEF	Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
QSH	Qendra Shëndetësore
SHKP	Shërbimi Kombëtar i Punësimit, zyra Tiranë
SHQK	Shkolla Qendër Komunitare
TLAS	Shërbimi Ligjor Falas Tiranë
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
YWCA	Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare

Falenderime

Janë të pakta qytetet që kanë arritur të bëjnë kaq shumë për komunitetin rom dhe egjiptian në një kohë kaq të shkurtër sa Tirana. Edhe pse me mundësi të kufizuara, me mjete financiare shumë herë më modeste sesa ato të shumë qyteteve të tjera europiane, me projektet e suksesshme të strehimit dhe integritit në Lanabregas dhe Shkozë, Tirana është sot në pararojë të gjetjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme për integrimin e këtij komuniteti.

Ne besojmë që një qytet si Tirana duhet të garantojë mirëqenie e cilësi sa më të lartë jetese për të gjithë qytetarët pavarësisht mbiemrit apo ngjyrës së lëkurës. Kemi punuar me shumë dashuri e përkushtim për të arritur pikërisht këtë, duke bashkuar forcat me partnerë vendas e të huaj. Dhe kemi arritur të bëjmë diçka realisht të bukur. Sigurisht ky është vetëm fillimi dhe na mbetet ende shumë punë për të bërë, por s'ka asnjë dyshim që Tirana ofron sot një model funksional dhe efikas jo vetëm për strehimin, por edhe për integrimin e plotë të komunitetit rom e egjiptian.

Ofrimi i mundësive për shërbime shëndetësore, arsimore, punësim e strehim kanë qenë një hap i parë shumë i rëndësishëm që na tregoi që ky problem e ka një zgjidhje dhe kjo zgjidhje është brenda mundësive të Tiranës. Plani i Veprimit për Zhvillimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian 2018-2020, nga ana tjetër, është një dokument shumë i rëndësishëm që do të na lejojë të ndërtojmë mbi punën e bërë për t'i kthyer sukseset e deritanishme në arritje të qëndrueshme.


Për herë të parë Bashkia e Tiranës ka një Plan Lokal Veprimi me masa konkrete dhe të kostuara mirë, që do të ndërmerren nga aktorët vendorë dhe rajonalë, duke synuar thyerjen e barrierave që pengojnë integrimin dhe përfshirjen sociale të komunitetit Rom dhe Egjiptian në shoqëri.

Ai vjen si rezultat i një procesi të gjatë dhe gjithëpërfshirës, takimesh e konsultimesh të gjera, përpjekjesh dhe bashkërendimi pune me të gjithë aktorët që veprojnë në sektorë të ndryshëm, dhe reflekton nevojat reale dhe urgjente të komunitetit Rom dhe atij Egjiptian në Tiranë.

Ka qenë një punë e gjatë, për të cilën kanë kontribuar shumë aktorë si: Zyra Rajonale e Punësimit, Zyra Rajonale e Shërbimit Social, Autoriteti Shëndetësor Rajonal, Drejtoria Arsimore Rajonale, Instituti i Shëndetit Publik, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, por edhe shumë organizata të shoqërisë civile dhe aktivistë, të cilët të gjithë meritojnë falenderimin dhe mirënjohjen tonë. Një falenderim i veçantë shkon për Bashkimin European dhe për Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) në Shqipëri dhe për realizimin e këtij Plani Lokal në kuadër të Projektit “Fuqizimi Ekonomik dhe Social i Romëve dhe Egjiptianëve - një shtysë për përfshirje sociale” si edhe për grupin e ekspertëve të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), të cilët asistuan përgjatë procesit planifikues.

Falë këtij dokumenti ne kemi sot një hartë me hapa e masa konkrete për të adresuar njëherë e mirë një plagë sociale të bartur prej dekadash. Askush nuk ka ndonjë iluzion se kjo do të jetë e lehtë, por nisur nga puna e bukur e bërë gjatë dy viteve të shkuara, dëshira dhe solidariteti i jashtëzakonshëm që kemi gjetur në çdo hap nga institucione, shoqata, trupi diplomatik, por edhe qytetarë të thjeshtë, unë s’kam asnjë dyshim që kjo është një sfidë që ne do ta përballojmë me sukses, duke e bërë Tiranën një qytet më të mirë për të gjithë qytetarët e saj.

KRYETARI
Erion Veliaj



HYRJE



Plani për Zhvillimin e Komunitetit Lokal Rom dhe Egjiptian është një instrument demokratik planifikimi dhe menaxhimi që synon të adresojë në terma afatshkurtër sfidat me të cilat përballen të dy komunitetet duke synuar në arritjen e një vizioni që lidhet me një shkallë më të lartë integrimi të anëtarëve të të dy komuniteteve në jetën sociale dhe ekonomike në nivel lokal.

Ky plan shërben si një mekanizëm orientues i veprimeve që aktorët vendorë dhe rajonalë duhet të ndërmarrin për të adresuar sfidat dhe barrierat që pengojnë dy komunitetet në sigurimin e një jete dinjitoze. Dokumenti i planit fillimisht jep një pasqyrë të situatës aktuale të komunitetit Rom dhe Egjiptian lidhur me sfidat kryesore (ku jemi aktualisht) në lidhje me: regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë; b) arsimimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor; c) kujdesin shëndetësor; d) punësimin dhe formimin dhe edukimin profesional; e) strehimin dhe integrimin urban, si dhe f) mbrojtjen sociale). Pas analizës së situatës aktuale, plani propozon vizionin për zhvillimin e dy komuniteteve (si duam ta shohim komunitetin Rom dhe Egjiptian pas 7-10 vitesh?) dhe cili është itinerari për të arritur aty ku dëshirojmë në të ardhmen, ose me fjalë të tjera plani i veprimit që adreson sfidat sipas gjashtë fushave prioritare. Plani i veprimit paraqet qëllimet strategjike dhe objektivat specifike për gjashtë fushat, ndërsa çdo objektiv ka të renditura projektet dhe hapat e veprimit konkret, të cilat janë të detajuara në lidhje me ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet aktorëve lokalë dhe rajonalë, implikimet financiare, burimet e të ardhurave si dhe treguesit e performancës dhe afatet kohore. Zbatimi i hapave të veprimit në përputhje me afatet kohore dhe treguesit e synuar duhet të monitorohet dhe të raportohet.

PZHK është një instrument praktik dhe relativisht i thjeshtë për t'u përdorur jo vetëm nga aktorët publik (administrata lokale e bashkisë

dhe e institucioneve të tjera vendore të dekoncentruara si Drejtoria Arsimore Rajonale, Fondi Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik, Policia, etj.) por edhe nga aktorët e shoqërisë civile, grupet e ndryshme sociale, në kontributin e tyre për adresimin e sfidave sipas veprimeve të parashikuara në Plan, duke bërë të realizueshëm edhe vizionin e artikuluar në dokument. Koordinimi i përpjekjeve ndërmjet aktorëve lokalë për zbatimin e këtij plani është tejet i rëndësishëm duke marrë në konsideratë faktin që një dokument i tillë reflekton nevojat dhe preferencat e anëtarëve të dy komuniteteve dhe të aktorëve të tjerë lokalë. Procesi planifikues ka siguruar hapësirë që anëtarët e dy komuniteteve të kenë një zë në vendimet që ndikojnë zhvillimin e tyre dhe ndërhyrjet për zhvillim të jenë të përshtatshme me nevojat dhe preferencat e tyre. Procesi i hartimit të planit ka patur natyrë të lartë pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse dhe dokumenti final është rezultat i konsultimeve të gjera me aktorë publik dhe jopublik që veprojnë në sektorë të ndryshëm.


Pikërisht identifikimi i (dis)avantazheve të vazhdueshme që përballet ky komunitet dhe orientimi i politikave vendore në funksion të përfshirjes dhe zhvillimit socio-ekonomik të komuniteteve vulnerabelë kërkon një ndërhyrje efektive ndërsektoriale dhe shumëaktorisë në nivel vendor. Një plan strategjik është jo vetëm një parakusht për të mobilizuar burime të tjera financimi dhe akses në fonde nga donatorë të ndryshëm, por edhe një tregues tepër i rëndësishëm në përpjekjen për të rritur mirëqenien, integrimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për këto grupe në nevojë. E thënë ndryshe, politikat në nivel vendor të orientuara drejt përfshirjes sociale kanë një efekt pozitiv jo vetëm në adresimin e nevojave dhe sfidave me të cilat përballen këto komunitete, por edhe më tej në integrimin e qëndrueshëm në fushat prioritare si punësimi, arsimi, strehimi, mbrojtja sociale, shëndetësia.

Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës fokusohet në trajtimin e gjashtë sfidave të identifikuara edhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, të lidhura ngushtë me kontekstin vendor. Ky plan zhvillimi është hartuar me synimin që të shërbejë si instrument për orientimin e përpjekjeve ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe në lidhje me integrimin social dhe ekonomik të dy komuniteteve në Bashkinë e Tiranës. Njohja e mirë e potencialeve dhe sfidave me të cilat përballen dy komunitetet në 6 fushat prioritare: regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë, arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, kujdesi shëndetësor, punësimi dhe formimi profesional, strehimi dhe integrimi urban, si dhe mbrojtja sociale, arrin të mbulojë dhe adresojë gamën e gjerë të problematikave shumëdimensionale të dy komuniteteve.

Ky dokument është i organizuar në katër kapituj kryesorë. Në kapitullin e parë përshkruhet qasja metodologjike e procesit planifikues të këtij dokumenti, parimet e planit, modeli konceptual i procesit planifikues sipas fazave, instrumentet e përdorur, duke vënë theksin edhe te aktorët e përfshirë në këtë proces. Në kapitullin e dytë paraqitet situata aktuale e komuniteteve romë dhe egjiptiane në Bashkinë e Tiranës sipas gjashtë fushave prioritare të përmendura më sipër. Kapitulli i tretë paraqet deklaratën e Vizionit dhe qëllimet strategjike të planit, i cili vijon me kapitullin e matricës së planit të veprimit që përfshin qëllimet strategjike, objektivat specifike, aktivitetet sipas fushave prioritare. Në kapitullin e fundit, rëndësi e veçantë i kushtohet monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të planit, pasi është tejet e nevojshme dhe e rëndësishme ndjekja e zbatimit të strategjisë për të vlerësuar rezultatet e pritura të objektivave strategjike.

Qëllimi kryesor i procesit planifikues është t'u jap grupeve vulnerabël si rom dhe egjiptian një mjet që fuqizon në mënyrë të veçantë grupet në nevojë, duke i bërë ato pjesëmarrëse direkte në vendimmarrje, nëpërmjet dizenjimit të aktivitete konkrete të planit të veprimit për zhvillim nga vetë ata. Kjo bëhet më domethënëse kur planifikimi i zhvillimit synon specifikisht grupet në nevojë, si komunitetet Rome dhe Egjiptiane, të cilët jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike dhe janë të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse që ndikojnë jetët e tyre, por konkretisht edhe nga një sërë shërbimesh publike.

Shkëputur nga Guida (IDM 2017)



KAPITULLI 1

QASJA METODOLOGJIKE



Parimet udhëzuese të planit të zhvillimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian

Në thelb të të gjitha nismave në nivel lokal që synojnë integrimin e anëtarëve të komuniteteve rome dhe egjiptiane duhet të mbeten të gjitha parimet e mëposhtme, duke vënë theksin në qasjen ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe që ato kërkojnë. Si pasojë e nevojës së kësaj qasje, ajo çka është emergjente dhe realiteti i aktorëve vendorë në Shqipëri kërkon është forcimi i koordinimit mes institucioneve në nivel lokal si dhe partneriteti ndërmjet sektorit publik dhe jopublik.

Nxitja e përfshirjes sociale

Plani i Zhvillimit të Komunitetit i kushton një vëmendje të veçantë nxitjes së përfshirjes sociale të komunitetit Rom dhe Egjiptian. Plani orientohet veçanërisht në përpjekjet për të rritur aksesin e romëve dhe egjiptianëve në punësimin formal, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor, si edhe në programet e mbrojtjes sociale, në kujdesin shëndetësor, në aksesin në sistemin e drejtësisë, strehimin me qëllim rritjen e mirëqenies së këtij komuniteti dhe integrimin në jetën sociale dhe ekonomike në komunitetet lokale. Plani promovon parimin e përfshirjes sociale duke i përfshirë vetë anëtarët e grupeve vulnerabël në procesin e planifikimit strategjik.

Respektimi i dallimeve

Plani i Zhvillimit të Komunitetit respekton dallimet që ekzistojnë ndërmjet komunitetit Rom dhe atij Egjiptian në fushat e ndryshme prioritare. Po ashtu, plani bën dallim edhe midis diferencave që ekzistojnë brenda vetë nëngrupeve të këtyre komuniteteve, duke mos homogjenizuar grupin/komunitetin si një të tërë. Integrimi i dy komuniteteve vazhdon të jetë ende një sfidë në vazhdimësi, e megjithatë plani njeh faktin se disa nëngrupe janë tashmë më të integruara në shoqëri.

Qasja ndërsektoriale:

Plani i Zhvillimit të Komunitetit vë theksin në nevojën e një qasje ndërsektoriale dhe shumëaktorëshe që përpjekjet për integrimin e dy komuniteteve të sjellin vërtet rezultate. Integrimi në jetën sociale dhe ekonomike të romëve dhe egjiptianëve është i mundur në adresimin e barrierave të përfshirjes sociale në mënyrë të integruar, pra njëkohësisht në shumë prej sektorëve si: arsimimi, shëndetësia, strehimi dhe integrimi urban, punësimi dhe arsimit e aftësimi profesional, mbrojtja sociale, regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë, duke promovuar zhvillimin dhe integrimin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme përmes ndërhyrjeve ndërsektoriale.

Zbatimi i planit thekson rëndësinë që merr koordinimi i aktorëve lokalë publik dhe jopublik.

Dimensoni i integritit gjinor:

Plani i Zhvillimit të Komunitetit nënvizon rëndësinë e integritit të dimensionit gjinor në të gjitha hapat dhe proceset e ndërmarra në këtë kuadër. Integrimi gjinor në terma konkret përkthehet në të dhënat e disagreguara sipas gjinisë dhe në po të njëjtën kohë në hartimin e objektivave duke patur parasysh pasojat e tyre për të dyja gjinitë. Për më tepër, plani pranon faktin se gratë rome dhe egjiptiane kanë më shumë gjasa të ndihen të diskriminuara dhe të përjashtuara. Kjo, së pari për shkak të racës, dhe së dyti për shkak të gjinisë. Gratë në përgjithësi kanë një qasje më të kufizuar ndaj burimeve ekonomike dhe vendimmarrjes, shpesh për shkak të mentalitetit dhe praktikave tradicionale të cilat kontribuojnë në pabarazitë dhe përjashtimin e tyre të vazhdueshëm nga jeta sociale dhe shoqërore. Veprimet e planit kanë një ndjeshmëri gjinore dhe promovojnë arritjen e parimit të barazisë gjinore. Ulja e hendekut të pabarazive midis grave dhe burrave është një element tepër i rëndësishëm i qeverisjes së mirë dhe pritshmërive që BE parashtron ndaj çdo vendi kandidat në lidhje me integrimin gjinor.

Parimi i pjesëmarrjes aktive:

Angazhimi konstruktiv i aktorëve lokalë dhe vetë komunitetit Rom dhe Egjiptian në të gjitha hapat e PZHK-së siguron një model të qëndrueshëm të vendimmarrjes pjesëmarrëse dhe efektive. Procesi i hartimit të planit është në funksion të gjithëpërfshirjes ku në mënyrë të veçantë anëtarët e dy komuniteteve ndihen të përfaqësuar përmes anëtarëve të vetë komunitetit në grupin e punës. Procedurat e ndjekura në hartimin e planit sigurojnë gjithashtu një model transparent të demokracisë pjesëmarrëse, ku vetë komuniteti ndihet i mirëdëgjuar përsa i përket vendimeve të cilat do të influencojnë dhe ndikojnë padyshim në vetë cilësinë dhe mirëqenien e jetës së tyre.

Barazia përpara ligjit dhe parimi i mosdiskriminimit:

Të gjitha aktivitetet e planifikuara në kuadër të Planit të Veprimit do të kenë në qendër të vëmendjes së tyre respektimin e të drejtave dhe garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit përpara ligjit. Parimi i barazisë përpara ligjit dhe ai i mosdiskriminimit qëndrojnë në themel të Kushtetutës së Shqipërisë (Neni 18) si edhe në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut të vitit 1948 (Neni 2). Sipas këtij parimi, çdo individ gëzon të drejtat dhe liritë e përcaktuara pa asnjë kufizim përsa i përket gjinisë, racës, gjuhës, përkatësisë fetare, mendimit politik, origjinës kombëtare e shoqërore, pasurisë, përkatësisë në një minoritet kombëtar, lindjes ose çdo status tjetër social ekonomik apo arsimor.

Modeli konceptual: Hartimi i planit të zhvillimit të komunitetit

Faza përgatitore

Vlerësimi i komunitetit

HAPI 1: Identifikimi i aktorëve

HAPI 2: Garantimi i angazhimit politik

HAPI 3: Ofrimi i mbështetjes teknike dhe ngritja e grupeve të punës dhe nën-grupeve të punës

HAPI 4: Mbledhja e informacionit

HAPI 5: Mobilizimi i komunitetit

HAPI 6 - Të dhënat: Fushat prioritare të planit

- 1- Regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi
- 2- Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor
- 3- Punësimi, arsimi dhe formimi profesional
- 4- Kujdesi shëndetësor
- 5- Strehimi dhe integrimi urban
- 6- Mbrojtja sociale

HAPI 8:

Analiza,
sintetizimi i të
dhënave

SWOT

HAPI 7:

Pema e
problemeve

HAPI 9:

Ofrimi i asistencës

- 1- Vizioni
- 2- Qëllimi strategjik
- 3- Objektivat specifk

HAPI 10:

Pema e objektivave

HAPI 11:

Aktivitetet
Institucionet
Periudha kohore
Burimi i financimit
Indikator
Treguesi bazë
Treguesi i synuar 2020
Burimi i të dhënave

HAPI 16:

Monitorim dhe vlerësim

HAPI 15:

Zbatimi i planit

HAPI 13:

Finalizimi i planit

HAPI 14:

Aprovimi i dokumentit
në këshill

HAPI 12:

Konsultimi me
aktoret e interesit
& publikun

Rishiko



Metodologjia

Për hartimin e Planit të Zhvillimit është përdorur një kombinim i metodologjisë kërkimore sasiore dhe cilësore duke u bazuar edhe në të dhënat parësore dhe dytësore nga institucionet respektive në Bashkinë e Tiranës.

Metodologjia kërkimore përfshin:

- 1) Intervista gjysëm të strukturuar ballë për ballë me anëtarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian;
- 2) Intervista të thelluara me informantë kyç nga institucionet vendore dhe shoqëria civile;
- 3) Fokus grupe me banorë të komuniteteve;
- 4) Sesion SWOT me anëtarët e grupit lokal të punës;
- 5) Workshope me grupin e punës, duke përfshirë punën në grupe tematike.

Aktorët e përfshirë

Identifikimi dhe përfshirja e aktorëve kryesorë në zhvillimin lokal është thelbësore për hartimin me sukses të këtij plani zhvillimi. Duke pranuar se çështja e integritit dhe fuqizimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane kërkon një qasje ndërsektoriale, shumëaktorëshe dhe gjithëpërfshirëse për vetë kompleksitetin e sfidave dhe problemeve me të cilat përballen, procesi i draftimit dhe konsultimit të planit ka përfshirë aktorë të ndryshëm si nga sektori publik ashtu edhe jopublik. Përfshirja e gjerë e aktorëve përgjatë procesit planifikues është një parakusht i domosdoshëm për të krijuar një model të qëndrueshëm, racional dhe vizionar të planit. Kjo qasje kërkon gjithashtu një përfshirje edhe më të përgjegjshme në procesin e zbatimit dhe të monitorimit të planit, me qëllim që plani të mos jetë thjesht një dokument statik, por të lejojë fleksibilitetin e ndërhyrjeve në koherencë me zhvillimet/ndryshimet aktuale që paraprin komunitetin. Pra, vizioni për planin është më shumë se një produkt, pasi ai reflekton një qasje më dinamike të mekanizmave institucional në nivel vendor për të adresuar/rishikuar me fleksibilitet nevojat në zhvillim. Grupi lokal me pjesëmarrje i planit të zhvillimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane kishte në përbërjen e tij si më poshtë:

Grupi Lokal me pjesëmarrje të PZHK

Këshilli bashkiak & NJQV

- Të zgjedhurit lokal
- 3-4 anëtarë të Këshillit Bashkiak
- 3-5 administratorë të Njësive Administrative

Stafi kyç i Bashkisë


- Drejtorja e planifikimit dhe zhvillimit të territorit
- Drejtorja e financave & buxhetit
- Drejtorja shërbimeve sociale
- Njësia e mbrojtjes së fëmijëve
- Ndhma ekonomike
- Gjendja civile

Përfaqësues të autoriteteve të tjera publike

- Zyra Rajonale e Punësimit
- Zyra Rajonale e Shërbimit Social
- Drejtorja Rajonale e Shëndetit Publik
- Drejtorja Arsimore Rajonale
- Drejtorja e Policisë
- Fondi i Sigurimeve të Detyrueshme të kujdesit shëndetësor, Durrës
- Qendra Shëndetësore

Shoqëria civile & Komuniteti

- 3-5 anëtarë të forumeve të këshillimit të komunitetit
- Përfaqësues nga organizata lokale të shoqërisë civile
- Aktivistë



KAPITULLI 2

ANALIZA E SITUATËS AKTUALE



Një përmbledhje e situatës aktuale

Aksesi në të drejtat politike, sociale, shëndetësore, arsimore është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me regjistrimin civil. Nuk ka të dhëna të plota dhe të sakta zyrtare se sa romë dhe egjiptianë jetojnë në Tiranë. Sipas Censurit¹ popullata rome banon në 12 njësi administrative të Bashkisë Tiranë, përbëhet prej rreth 855 njësi ekonomike familjare dhe përbën rreth 26% të popullsisë rome në shkallë vendi.

Ka romë dhe egjiptianë të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile që vijnë si pasojë e lindjeve jashtë sistemit shëndetësor, lindjeve nga prindër nën moshë, lindjeve në lëvizje, moskuptimit të rëndësisë dhe procedurave të regjistrimit civil apo dhe të vendbanimit, gjendjes së bashkëpunimit dhe koordinimit jo në nivelin e duhur mes strukturave që punojnë drejtëpërdrejt në komunitet etj.

Gjatë vitit 2016 janë identifikuar në shkallë vendi 462 fëmijë romë të paregjistruar, nga këto 292 u arritën të regjistrohen². Nuk ka të dhëna të veçanta për Bashkinë Tiranë. Romët, dhe më pak egjiptianët, hasin barriera në regjistrimin e vendbanimit apo të ndryshimit të tij për shkak të natyrës së tyre të lëvizshme apo shtegtare, vështirësive ekonomike, mungesës së çertifikatës së pronësisë ose të kontratës së qerasë së banesës në bashkinë ku janë shpërngulur³.

Niveli i arsimimit të popullsisë rome, dhe në një masë më të vogël egjiptiane është shumë më i ulët se i banorëve të tjerë. 48% e të intervistuarve në Census⁴ pohojnë të mos kenë shkuar asnjëherë në shkollë, ndërsa 21% deklarojnë ta kenë braktisur shkollën përpara se të përmbushnin arsimin e detyrueshëm. Në disa xhepa të izoluar të

1. OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

2. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

3. Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, Raport Vjetor 2015

4. OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

Tiranës niveli i analfabetizmit dhe braktisja e shkollës tek fëmijët e grupmoshës 8-15 vjeç është shumë e lartë, si për shembull në Shkozë ku 60% e fëmijëve janë analfabetë dhe 20% kanë braktisur shkollën⁵. Regjistrimi në arsimin parashkollor është dukshëm më i ulët për romët. Ndër 135 të intervistuarit nga komuniteti Rom dhe Egjiptian për hartimin e këtij plani (në vijim të intervistuarit), 35% e tyre deklarojnë se fëmijët e tyre nuk shkojnë në kopësht/shkollë. Një sfidë e madhe është evidentimi dhe trajtimi i çdo fëmije në situatë rruge. Për vitin 2016-2017 janë referuar për regjistrim në kopshte 122 fëmijë, dhe janë regjistruar vetëm 46 prej tyre. Frekuentimi i arsimimit nga fëmijët romë dhe egjiptianë është i ulët dhe shoqëruar me shumë probleme, ku ndër 150 të intervistuar, 69% e tyre deklarojnë se ka braktisje të shkollës nga fëmijët e tyre. Sipas të dhënave të marra nga drejtoritë arsimore, 15.2% e fëmijëve romë dhe egjiptianë kanë braktisur shkollën, nga këto 24.2% romë dhe 1.3% egjiptianë. Evidentohet një nivel i ulët i informimit dhe ndërgjegjësimit të prindërve për domosdoshmërinë e edukimit të fëmijëve. Në dy vitet e fundit Bashkia i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përmirësimit të infrastrukturës arsimore. Vitet 2015-2016 mund të quhen vite të çerdheve dhe kopshteve. Gjatë vitit 2017 në fokus janë shkollat, tre shkolla të reja janë ndërtuar dhe pritet që shumë shpejt të nisë edhe ndërtimi i 17 shkollave të tjera⁶.

Ka një shkallë të lartë papunësie të romëve dhe egjiptianëve: në Tiranë 47% e romëve dhe 56.2% e egjiptianeve janë të papunë, në aspektin gjinor 58.8% e femrave romë dhe 72% e femrave egjiptiane janë pa punë⁷. Në Tiranë sipas Censurit⁸ 51% e romëve të moshës 18-65 vjeç pohojnë

5. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezhi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve romë dhe egjiptiane

6. <http://www.tirana.al/viti-i-ndertimit-te-20-shkollave-ne-tirane-perurohet-shkolla-luigj-gurakuqi-per-femijet-me-aftesi-te-vecanta/> , aksesuar më 12.06.2017

7. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezhi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve romë dhe egjiptiane

8. OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën romë në Shqipëri, prill 2014

se nuk punojnë. Shkaqet e papunësisë sipas studimit⁹, romët dhe egjiptianët i lidhin me mungesën e mundësive të punësimit, nivelin e ulët arsimor, diskriminimin për shkak të etnisë, dhe me mungesën e aftësive profesionale. Romët janë përfshirë kryesisht në dy aktivitete kryesore, në mbledhjen/grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme dhe në shitjen e rrobave të përdorura, ndërkohë format e punësimit të egjiptianeve janë më të diversifikuara. Ka një shkallë të ulët informimi dhe ndërgjegjësimi të romëve dhe egjiptianeve rreth përfitimeve dhe rëndësisë së regjistrimit në zyrën e punës si punëkërkuar. Nga 123 të intervistuarit, 65% deklarojnë se nuk janë regjistruar në zyrën e punës si punëkërkuar të papunë dhe ndër shkaqet, ato pohojnë: *nuk kam shkuar, ka shumë procedura / s'ka punë për ne / nuk ka punë/ nuk kam informacion*.

Sipas të dhënave "Open data" në Bashkinë Tiranë janë 728 punëkërkuar në total për vitin 2016, dhe nga këto 150 janë romë dhe 47 janë egjiptianë. Të ardhurat mujore familjare paraqiten shumë të ulëta krahasuar me pagën minimale dhe të pamjaftueshme për të përballuar jetesën e përditshme. (69.5% vetëdeklarojnë të ardhura poshtë 20 mijë lekë, 14.6% me të ardhura mes 20-30 mijë dhe vetëm 5.2% mbi 50 mijë lekë). Në Tiranë ushtrojnë aktivitetin 4 shkolla profesionale publike dhe dy Qendra të Formimit Profesional (Nr 1 dhe 4). Nga 149 të intervistuarit, 80% pohojnë se nuk kanë ndjekur kurse të formimit profesional.

Në Tiranë shërbimet bazë shëndetësore për romët dhe egjiptianët mbulohen nga 19 qendra shëndetësore. Qasja në shërbimet shëndetësore të komunitetit Rom dhe Egjiptian është e shoqëruar më një seri problemesh dhe sfidash. Ato përballen çdo ditë me punë me risk të madh shëndetësor, keqshqyerje, trajtimi jo të mirë nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, etj. Ata kanë mungesë informacioni dhe njohurish rreth shëndetit riprodhues, shtatzanisë, sëmundjeve infektive dhe seksualisht

9. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezzi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane.

të transmetueshme, lindjeve dhe kujdesit për fëmijët. Rreth 38% e të intervistuarve pohojnë se anëtarët e familjes së tyre nuk janë të pajisur me kartë shëndeti. Ata nuk dinë ku ta marrin librezën shëndetësore dhe nuk i njohin procedurat. Bashkëpunimi qendër shëndetësore-komunitet nuk është në nivelin e duhur, nuk janë ngritur mediatorët e shëndetit, kapacitetet e personelit mjekësor (infermieret e terrenit) që mbulojnë komunitetin Rom dhe Egjiptian duhet të përmirësohen. Lëvizjet e shpeshta apo shtegtimet krijojnë vështirësi të mëdha për vaksinimin, për kujdesin ndaj fëmijëve të sapolindur dhe nënave shtatzëna.

Aksesi në programet sociale të strehimit nga komuniteti Rom është i ulët. Vetëm 3% e të intervistuarve deklarojnë se kanë përfiturar ndihmë nga shteti si të pastrehë, ndërkohë 76% deklarojnë se nuk kanë aplikuar ndonjëherë, 15% nuk e njohin këtë skemë ndihme. Ndër shkaqet e kësaj gjendje intervistuesit paraqesin “Nuk plotësojmë kushtet / nuk kam informacion / nuk di të aplikoj / nuk kam aplikuar sepse nuk di ku të drejtohem”. Nga ana e Bashkisë, ndërtimi dhe shpërndarja e banesave sociale, si dhe ofrimi bonus strehimi grupeve të pafavorizuara, ka qenë në fokus të punës së saj në vitet e fundit. Sipas Bashkisë rreth 177 familje, nga këto 60% familje rome dhe 40% egjiptiane, janë përfutues nga skemat e Bashkisë për strehim social. Një numër i konsiderueshëm i familjeve rome jetojnë në baraka dhe në kushte jo të përshtatshme higjieno-sanitare, në hapësira të pamjaftueshme, pa ngrohje, me kufizime e mungesa në furnizimin me ujë të pijshëm, banjave dhe kanalizimeve. Familjet rome jetojnë kryesisht në vendbanime informale, në troje që nuk u përkasin atyre ose në troje me pronësi të diskutueshme, në shtëpi pa dokumenta pronësie. Vitet e fundit nuk janë ofruar grante të vogla për përmirësimin e kushteve të banimit të romëve. Ka pasur disa raste të zhvendosjes së romëve si rezultat i ndërtimit të objekteve publike.

Mbrojta sociale është një nga mekanizmat kryesor të zbutjes së varfërisë e të përjashtimit social. Evidentohet se kemi të bëjmë me akses të ulët të

komunitetit Rom dhe Egjiptian në programet e mbrojtjes sociale. Mungesa e informacionit mbi programet e mbrojtjes sociale është në nivele të larta, 67% e 122 të të intervistuarve pohojnë së nuk kanë dijeni/ informacion mbi këto programe. Komuniteti Rom dhe Egjiptian është nga komunitetet me shkallën më të lartë të varfërisë. Sipas një studimi të UNDP¹⁰ rezultojnë se 77.7% e familjeve rome dhe 84.1% e atyre egjiptiane bëjnë pjesë në grupin “shumë të varfër”, ndërsa 6.1% e romëve dhe 7.8% e egjiptianëve janë të varfër. Në Tiranë, sipas të dhënave të studimit¹¹, 67.7% e romëve dhe 75.5% e egjiptianëve kategorizohen shumë të varfër, 16.8% e romëve dhe 10.6% e egjiptianëve të varfër dhe vetëm 14.8% e romëve dhe 13.9% e egjiptianëve kategorizohen jo të varfër. Në vitin 2016, 325 familje (38% familjeve rome) janë trajtuar me ndihmë ekonomike, ndërkohë në vitin 2017 janë trajtuar me ndihmë ekonomike 302 familje, ose 7.1% më pak se në 2016. Në Bashkinë e Tiranës funksionon Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMF), dhe 11 skuadra terreni të cilët identifikojnë dhe referojnë raste të fëmijëve në situatë rruge. Vetëm 35.6% e fëmijëve romë në situatë rrugë janë regjistruar në kopshte dhe 41.7% në shkolla, në periudhën 2015-2017. Me rëndësi shihet përmirësimi i bashkëpunimit dhe i shkëmbimit të informacionit mes NjMF, Zyrës së Punës, punonjësve të njësive administrative, organizatave dhe donatorëve të ndryshëm që ofrojnë shërbime për fëmijët, si dhe shtimi i burimeve njerëzore në njësitë administrative për identifikimin, vlerësimin e nevojave, adresimin dhe menaxhimin e rasteve. Për t’ju ofruar shërbime grupeve në nevojë janë ngritur dhe funksionojnë në vartësi të Bashkisë katër Qendra Sociale. Ato përballen me burimet e pamjaftueshme financiare, mungesë pajisjesh, probleme me infrastrukturën dhe me mungesën e mjediseve të duhura. Shihet si nevojë ngritja e qendrave të reja sociale, si dhe shtimi i orareve të punës për ekzistueset etj.

10. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

11. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezi, Eriselda Dana, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Regjistrimi Civil dhe Aksesit në Sistemin e Drejtësisë

Nuk ka të dhëna të plota dhe të sakta zyrtare se sa romë dhe egjiptianë jetojnë në Tiranë. Sipas Censurit¹², në Bashkinë Tiranë banojnë 855 njësi ekonomike familjare (NjEF) rome, ose rreth 26% e popullsisë rome në shkallë vendi. Ata janë të shpërndarë në 12 njësi administrative (NjA): (NjA 1-46 NjEF, NjA 4- 290; NjA 5- 175; NjA 6- 48; NjA 7- 6; NjA 8- 55; NjA 9- 32; NjA 11-111; Dajt- 49; Farkë- 16; Kashar-20 dhe Vaqarr 7).

Megjithëse përmbledhen në një grup të vetëm si romë, ato ndahen në pesë nëngrupe/subkultura¹³ sipas vetëdeklarimit të tyre (Erli si grupi më i madh me 448 NjEF; Meckar me 250 NjEF; Çergarët 109 NjEF; Kallbuxhi 21 NjEF; Bamill 1 NjEF, 19 nuk e dinë nëngrupin dhe 7 mikse) të cilët dallohen nga njëri-tjetri përgjithësisht nga dialekti, periudha kur kanë mbërritur në Shqipëri, si dhe trajektorja e rrugëtimit. Aksesit në të drejtat politike, sociale, shëndetësore, arsimore është i lidhur në mënyrë të pazgjydhshme me regjistrimin civil. Konventa për të drejtat e fëmijëve¹⁴ përcakton se "Fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind, dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi".

Të dhënat flasin se ka fëmijë romë dhe egjiptianë të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile.

Në Planin e Veprimit¹⁵ pohohet se në shkallë vendi, në vitin 2014 u regjistruan 148 fëmijë nga komuniteti Rom si regjistrime të vonuara, dhe u identifikuan rreth 500 raste individë romë që kanë nevojë për ndihmë të llojeve të ndryshme për regjistrimin në gjendjen civile. Në periudhën korrik 2015 – qershor 2016, në Tiranë janë regjistruar në Gjendjen Civile si regjistrime të vonuara dy fëmijë në situatë rruge¹⁶. Sipas të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) gjatë vitit 2016

12. OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

13. Po aty.

14. Neni 7 i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve e ratifikuar me Ligjin Nr. 7531 datë 11.12.1991, FI.Zyrtare Ekstra 89, viti 2013

15. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072, datë 23.12.2015

16. Plani Kombëtar i Veprimit "Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015-2017" Raport vjetor korrik 2015 – qershor 2016

janë identifikuar në shkallë vendi 462 fëmijë romë të peregjistruar, nga këto 292, ose 63.2%, u arrit të regjistrohen. Ishte e pamundur sigurimi i të dhënave veçmas për Bashkinë e re të Tiranës.

Ndër shkaqet kryesore të ekzistencës së fëmijëve romë dhe egjiptianë të peregjistruar në regjistrin civil, evidentohen:

- a. Lindjet jashtë sistemit shëndetësor: Dokumenti bazë për vërtetimin e lindjes është çertifikata e asistencës në lindje, që i jepet nënës nga personeli mjekësor në momentin e lindjes së fëmijës. Në komunitetin Rom, më pak tek ai egjiptian, por edhe në atë të mazhorancës, ka lindje që ndodhin jashtë sistemit shëndetësor, pohojnë punonjësit, të cilët i shërbejnë drejtëpërdrejt komunitetit... “është fakt lindja e fëmijëve jashtë strukturave shëndetësore. Këto lindje nuk regjistrohen rregullisht, nuk ka statistika të sakta, dhe nuk raportohen në mënyrë të saktë tek strukturat shëndetësore ose zyrat e gjendjes civile¹⁷”.
- b. Martesat në moshë shumë të hershme: Shumë të rinj, por sidomos vajzat rome, martohen në një moshë shumë të hershme. 19% e vajzave rome martohen në moshën 13 deri në 17 vjeç¹⁸. “Edhe dje, edhe sot, ne martohemi shpejt, kryesisht në moshën 12-13 vjeç, kjo është tradita jonë” shprehet një i intervistuar në Tiranë Kjo traditë bie ndesh me ligjin¹⁹ dhe sjell disa pasoja, së pari prindërit e rinj nën moshë hezitojnë t’i drejtohen zyrës së gjendjes civile për regjistrimin e fëmijës, dhe së dyti punonjësit e gjendjes civile, sipas një të intervistuar, nuk pranojnë të regjistrojnë fëmijët me prindër nënmoshë.
- c. Niveli shumë i ulët arsimor: Një tjetër arsye e problemeve me regjistrimin e lindjeve dhe të vendbanimit është niveli shumë i

17. TLAS, Studimi dhe vlerësimi i situatës për mundësimin e regjistrimit elektronik të të porsalindurve në Shqipëri, Raporti Final

18. OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

19. Neni 7 i Ligjit Nr. 9062, datë 08.05.2003, Kodi i Familjes “Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç”

ulët arsimor i prindërve, rreth 48% e të intervistuarve në Census²⁰ deklarojnë të mos kenë shkuar asnjëherë në shkollë, ndërsa 21% deklarojnë ta kenë braktisur shkollën përpara se të përmbushin arsimin e detyrueshëm, kjo ka shkaktuar që shumë prindër romë të mos e kuptojnë rëndësinë dhe procedurat e regjistrimit civil apo dhe të vendbanimit.

- d. Fëmijë të lindur në lëvizje: Për arsye të përpjekjeve të mëdha për të siguruar mjetet e jetesës romët “shtegtojnë” vazhdimisht, ndryshojnë vendin e vendosjes se tyre në mënyrë të vazhdueshme, kanë një stil jetese gjithmonë në lëvizje, lëvizin brenda dhe jashtë vendit, lëvizin me dhe pa adresë. Gjatë këtyre lëvizjeve ndodhin lindje fëmijësh. Në lindjet në lëvizje brenda vendit, familjet rome për shkak të mungesës së lejes së banimit dhe të problemeve me sigurimin ditor të ushqimit dhe strehës neglizhojnë regjistrimin e fëmijës. Ndërkohë në rastet e lindjeve jashtë vendit, situata është shumë më komplekse dhe me një seri sfidash nga ana e dokumentacionit. Probleme të mëdha po evidentohen me fëmijët e lindur në Greqi.
- e. Koordinimi dhe raportimi jo në nivelin e duhur. Në nivelin lokal, megjithëse ka një përmirësim të dukshëm të koordinimit mes strukturave që punojnë drejtëpërdrejt në komunitet (punonjësve socialë, shëndetësorë, gjendjes civile, administratorëve shoqëror, policisë, organizatave të shoqërisë civile), përsëri ka nevojë për përmirësim të koordinimit dhe të raportimit të ndërsjelltë të të dhënave mbi lindjen dhe regjistrimin e vendbanimit (shëndetësi-gjendje civile). Rreth 88.4% e njësisve shëndetësore raportojnë të dhënat për të porsalindurin vetëm tek strukturat shëndetësore, siç parashikohet në rregulloret e brendshme të Ministrisë së Shëndetësisë, dhe vetëm 11.6% e tyre shprehen se raportojnë

20. OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

lindjet drejtëpërdrejt, dhe në zyrat e gjendjes civile²¹. Rrjeti European i Pashtetësisë (ENS) duke përdorur si burim një studim të shoqatës TLAS²² deklaroi se "... ka një hendek prej 10% mes lindjeve të raportuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe numrit të lindjeve të regjistruara nga zyrat e gjendjes civile në të njëjtin vit.... dhe duke patur në konsideratë që në zyrat e gjendjes civile ka gjithashtu të regjistruar fëmijë të cilët kanë lindur jashtë institucioneve shëndetësore, mund të arrijmë në konkluzionin se diferenca është edhe më e madhe". Ky hendek mund të jetë më i madh tek komuniteti Rom dhe Egjiptian, sepse ato përballen me vështirësi dhe probleme të shumta me regjistrimin civil.

Romët, dhe më pak egjiptianët, hasin barriera në regjistrimin e vendbanimit apo të ndryshimit të tij për shkak të natyrës së tyre të lëvizshme apo shtegtare, vështirësive ekonomike, mungesës së çertifikatës së pronësisë ose të kontratës së qerasë së banesës në bashkinë ku janë shpërngulur²³. Të intervistuarit pohojnë se duhen shumë dokumenta dhe lekë, dhe ne nuk dimë ku të drejtohem; individë nga komuniteti nuk janë të fokusuar te regjistrimi për shkak të problemeve sociale që kanë; mungon informacioni etj. Nga 150 të intervistuar, 7% pohojnë se e kanë shumë problem regjistrimin, 24% problem, 19% disi problem, dhe 45% s'është problem (shih grafikun 1 në vijim). Pohimet e sapo cituara janë të lidhura ngushtë me transferimin e vendbanimit zyrtar, duke patur parasysh se shumë familje rome/egjiptiane nuk mund të përgatitin dokumentacionin e kërkuar për transferim.

21. TLAS, Studimi dhe vlerësimi i situatës për mundësimin e regjistrimit elektronik të të porsalindurve në Shqipëri, Raporti Final


22. Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS)

23. Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, Raport Vjetor 2015

Nisma për integrimin e fëmijëve Romë dhe Egjiptianë në sistemin arsimor

Mosfunksionimi i 'Shansit të dytë', program për arsimimin e nxënësve që kanë braktisur shkollën që prej viti 2013, penalizon akoma më shumë kontigjentin e fëmijëve të cilët e kanë braktisur shkollën vite më parë apo ata të cilët nuk janë regjistruar asnjëherë në sistemin arsimor bazë. Këta fëmijë, përpos dëshirës për tu integruar dhe vijuar arsimin bazë, përjetojnë një sërë problemesh emocionale dhe paragjykimesh, për shkak se rikthimi në po të njëjtën klasë që kanë braktisur vite më parë (mosha mendore) nuk përkon me moshën e tyre fizike. Të ndodhur përballë një fenomeni të tillë, këta fëmijë detyrohen të braktisin shkollën brenda një kohë shumë të shkurtër.

Grafik.1 Perceptime mbi regjistrimin e komunitetit




Për shkak të nivelit të ulët arsimor, nivelit shumë të ulët ekonomik, kompleksitetit të dokumentave dhe procedurave të shumta administrative, komuniteti Rom dhe Egjiptian ka më shumë se çdo komunitet tjetër nevojë për ndihmë juridike/administrative për regjistrimin civil dhe të transferimit të vendbanimit zyrtar, për legalizimin e banesave, për përfitimin e ndihmës ekonomike, për përfitimin nga programet e strehimit social, programet e punësimit dhe një seri çështjesh të tjera. Ligjërisht, ndihma juridike/administrative normalisht ofrohet falas nga shërbimi i ndihmës juridike në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë, gjë që deri më sot është larg pritshmërive, objektivave dhe treguesve të parashikuar në plan veprimin²⁴ në të cilin është parashikuar “krijimi dhe bërja funksionale e klinikave rajonale ligjore për përmirësimin e aksesit ndaj shërbimeve ligjore për romët dhe egjiptianët” si dhe objektivi “në fund të vitit 2020, 100% e anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian do të kenë akses të plotë në shërbimin e gjendjes civile”. Kryesisht ndihma juridike/administrative deri më sot është ofruar nga organizata të ndryshme joqeveritare të mbështetura

24. VKM Nr.1072, datë 23.12.2015 “Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, 2016-2020”

nga UNDP, UNICEF etj., si dhe nga administrata e Bashkisë sipas fushave përkatëse. Por 17% e 146 të intervistuarve pohojnë se e nuk kanë përfituar ndihmën ligjore falas megjithëse ato kanë kërkuar (shih grafikun 2 në vijim) dhe 14% nuk kanë informacion për ndihmën ligjore falas.

Grafik.2 Ndhima ligjore falas



Në mënyrë të përmbledhur evidentohet se kemi të bëjmë me (i) akses të ulët në shërbimet e gjendjes civile dhe të ndihmës ligjore falas (ii) me fëmijë romë dhe egjiptianë të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile që vijnë si pasojë e lindjeve jashtë sistemit shëndetësor, lindjeve nga martesat në moshë shumë të hershme, lindjeve në lëvizje dhe nivelit të ulët të koordinimit dhe raportimit mes institucioneve të gjendjes civile dhe shëndetësore.

Arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor

Arsimimi i anëtarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian, duhet parë jo vetëm si një detyrim kushtetues, por si një nga mënyrat më efektive për integrimin e tyre të plotë në shoqëri²⁵. Arsimi bazë është i detyrueshëm

25. <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/content/20042016-fjala-e-ap-ziglli-totozani-ne-seminarin-e-dialogut-politik-shqiperi-be-perfshirjen-e>, aksesuar me 16.01.2017

për të gjithë fëmijët nga mosha 6 vjeç deri në 16 vjeç. Është në përgjegjësitë e bashkisë ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, gjithashtu administrimi dhe rregullimi i sistemit arsimor parashkollor, kopshteve dhe çerdheve²⁶. Bashkia ka për detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike. Ajo, në bashkëpunim me njësitë përkatëse arsimore vendore, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike dhe për mbështetjen e nxënësve të familjeve në nevojë²⁷.

Niveli i arsimimit të popullsisë rome, dhe në një masë më të vogël egjiptiane, është shumë më i ulët se i banorëve të tjerë. Në planin kombëtar²⁸ citohet se rreth 40.3% e romëve, dhe 12.7% e egjiptianëve janë analfabetë, ndërkohë mesatarja kombëtare është vetëm 1.6%²⁹. Kjo situatë konfirmohet edhe nga të dhënat e studimit³⁰, i cili evidenton se 37.4 % e romëve dhe 12.9% e egjiptianëve, të grupmoshës 16-55 vjeç, janë analfabetë. Gjithashtu, sipas të njëjtit studim, evidentohet fakti se në disa xhepa të izoluar të Tiranës niveli i analfabetizmit dhe braktisja e shkollës tek fëmijët e grupmoshës 8-15 vjeç është shumë e lartë, si psh, në Shkozë, ku 60% e fëmijëve janë analfabetë, dhe 20% kanë braktisur shkollën. Ndërkohë 48% e të intervistuarve në Census³¹ deklarojnë të mos kenë shkuar asnjëherë në shkollë, ndërsa 21% deklarojnë ta kenë braktisur shkollën përpara se të përmbushin arsimin e detyrueshëm. Një situatë pak më e përmirësuar paraqitet për Tiranën nga të dhënat e

26. Neni 23 i Ligjit Nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore

27. Neni 28 i Ligjit Nr. 69/2012 Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë

28. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 Datë 23.12.2015

29. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 Datë 23.12.2015

30. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezhi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane.

31. OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

studimit³² i cili evidenton se 26.1% e romëve dhe 1% e egjiptianeve nuk kanë shkuar asnjëherë në shkollë. Sipas UNICEF³³ në NjA nr. 4, nga 664 persona romë që banojnë aty, 172 persona vlerësohen analfabet dhe me vite mesatare të shkollimit 4.2 (përfshirë analfabetet), në NjA nr. 5, nga 919 romë që banojnë aty, 331 persona vlerësohen analfabetë dhe me vite mesatare të shkollimit 2.6 (përfshirë analfabetët). Ky nivel i ulët vjen për shkaqe nga më të ndryshmet, por në linja të përgjithshme mund të përmbliidhen (i) gjendja shumë e vështirë ekonomike e familjeve romë (ii) lëvizja e shpeshtë e tyre nga një vendbanim në tjetrin (iii) mentaliteti i gabuar i prindërve (iv) vështirësitë gjuhësore, etj.

Arsimi parashkollor ofrohet në kopshte e në klasa përgatitore për fëmijët e moshave 3 deri 6 vjeç. Të dhënat tregojnë se regjistrimi në arsimin parashkollor është dukshëm më i ulët për romët. Në Planin Kombëtar të Veprimit³⁴ deklarohet se 42% e fëmijëve romë të moshës 3-6 vjeç frekuentojnë arsimin parashkollor, krahasuar me afërsisht 50% të fëmijëve në të gjithë vendin, ndërsa ndër 135 të intervistuarit, 35% e tyre deklarojnë se fëmijët e tyre nuk shkojnë në kopësht/shkollë, dhe 58% shkojnë (shih grafikun 3 në vijim). Sipas UNDP, Bankës Botërore dhe KE³⁵, romë të regjistruar në arsimin parashkollor janë 34%, në krahasim me 57% për jo romët³⁶. Ndërkohë sipas UNICEF³⁷ në NjA nr. 4, nga 44 fëmijë (3-6 vjeç), 17 frekuentojnë kopshtin, në NjA nr. 5, nga 69 fëmijë 25 frekuentojnë kopshtin, në NjA nr. 1, nga 19 fëmijë vetëm 1 frekuenton kopshtin. Nga ana e UNICEF-it, me qëllim arsimimin që në fëmijërinë

32. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezhi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve romë dhe egjiptiane

33. http://www.sidalbania.org/articles.php?lang=al&pg=comm_al&m=view&commID=111, aksesuar më 22.05.2017

34. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 datë 23.12.2015

35. UNDP, Banka Botërore dhe KE. 2012. Romët në Shqipëri. <http://www.alundp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>, aksesuar më 24.05.2017

36. Po aty

37. <http://www.sidalbania.org/romamap.php?lang=en&pg=romabyregion&m=view®=Tirana>, aksesuar më 22.05.2017

e hershme dhe integrimin e fëmijëve romë në sistemin arsimor, që nga Tetori 2013 është formuluar dhe po zbatohet nisma “Çdo fëmijë Rom në kopësht”.³⁸ Për të mbështetur këtë nismë, Ministria e Arsimit me udhëzim³⁹ ka përcaktuar disa masa që duhet të ndjekin DAR, zyrat arsimore (ZA), drejtuesit e kopshteve dhe drejtuesit e shkollave. Në bazë të udhëzimit DAR, ZA kanë për detyrë të hartojnë një plan veprimi me objektiva të matshëm, statistika të komunitetit Rom, të dhëna për fëmijët romë 3-6 vjeç, si dhe tregues mbi progresin. Nisma “Çdo fëmijë Rom në kopësht” ka mundësuar përfshirjen e më shumë fëmijëve romë në kopësht, në shkallë vendi rreth 33% më shumë⁴⁰ në vitin shkollor 2014-2015 se sa në 2013-2014, ndërkohë në Bashkinë Tiranë u regjistruan 52 fëmijë në kopsht⁴¹. Ishte e pamundur të evidentoheshin efektet e kësaj nisme në Bashkinë Tiranë sepse planet e veprimit nuk u vendosën në dispozicion të grupit të punës, nuk janë publikuar në faqen e institucioneve arsimore, si dhe nuk u evidentua ndonjë monitorim apo raport progresi në lidhje me to. Sipas të dhënave⁴² nga Bashkia, në vitin 2016-2017 janë 218 fëmijë romë të regjistruar në arsimin parashkollor. Një nga sfidat është evidentimi dhe trajtimi i çdo fëmije në situatë rruge. Në raportin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve⁴³ evidentohet se për vitin 2015-2016 në Bashkinë Tiranë janë referuar për regjistrim në kopshte 55 fëmijë në situatë rruge, dhe janë regjistruar 17 prej tyre. Për vitin 2016-2017 janë referuar për regjistrim në kopshte 122 fëmijë, dhe janë regjistruar 46 prej tyre⁴⁴. Në të njëjtin raport konkludohet se “Për shkak të kuotave të limituara në kopshtet

38. Nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve (Observatori), Shoqata Kristiane e Grave Shqiptare (YWCA) dhe Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri (CRCA).

39. Udhëzim i MAS Nr. 21, datë 08.08.2014 Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë

40. <http://observator.org.al/sq/nisma-cdo-femije-rom-ne-kopesht/>, i aksesuar më 24.05.2017

41. Observatori për të drejtat e fëmijëve “Relacion të dhënash mbi situatën e të drejtave të fëmijëve”, Bashkitë e Qarkut Tiranë

42. Të dhëna nga Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore dhe Shëndetësore, Bashkia Tiranë


43. Plani Kombëtar i Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015-2017”, Raporti vjetor korrik 2015 – qershor 2016

44. Plani Kombëtar i Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015-2017”, Raporti vjetor korrik 2015 – qershor 2016

publike, dhe largësisë nga vendbanimi me kopshtet, nuk është arritur regjistrimi i të gjithë fëmijëve të referuar. Vështirësitë ekonomike të familjeve për të mbajtur një higjienë të pranueshme për fëmijët, dhe mungesa e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrim kanë qenë shkak për mosregjistrimin e tyre në kopsht⁴⁵.

Në strategjinë e zhvillimit të arsimit parauniversitar⁴⁵ është përcaktuar se “nga viti 2018, të gjithë fëmijët e grupmoshës 5-6 vjeç përfshihen në klasat përgatitore, ndërkaq 95% të grupmoshës 3-5 vjeç përfshihen në forma të ndryshme të edukimit parashkollor...” Për realizimin e këtyre treguesve, nga ana e Bashkisë kërkohet të merren disa veprime që kanë të bëjnë me rregullimin, planifikimin dhe financimin e arsimit parashkollor në kopshte dhe çerdhe për fëmijët romë dhe egjiptianë.

Grafik.3 Vijueshmëria e shkollës/kopshtit



Megjithëse në Shqipëri e drejta për arsimim ju garantohet shtetasve pa u diskriminuar nga raca, ngjyra, etnia, gjuha etj., si dhe arsimimi bazë është i detyrueshëm dhe falas për të gjithë fëmijët, evidentohet se arsimimi bazë i komunitetit Rom dhe Egjiptian mbart disa probleme dhe sfida të mëdha. Evidentohet se ka një numër fëmijësh romë

45. Strategjia e zhvillimit të arsimit parauniversitar, për periudhën 2014–2020, e miratuar me VKM Nr. 11, datë 11.01.2016

që nuk janë të regjistruar në arsimin bazë. Në arsimin e detyruar, shkalla e regjistrimit të romëve është 48%, në krahasim me 91% për jo-romët⁴⁶. Nga fokus grupet dhe intervistat rezulton se ka fëmijë të komunitetit Rom që banojnë në Bregun e Lumit NjA nr. 4 dhe nr. 8, Yzberisht, Shkozë, Siri Kodra, Nënstacioni Elektrik, 5 Maji, etj., që nuk kanë shkuar ndonjëherë në shkollë. Nga raporti⁴⁷ evidentojmë se “Për vitin shkollor 2015- 2016 në Bashkinë Tiranë janë referuar për regjistrim në shkolla 253 fëmijë në situatë rruge, dhe janë regjistruar 42 fëmijë. Për vitin shkollor 2016-2017 janë referuar për regjistrim 131, dhe janë regjistruar 118 fëmijë. Largësia e vendbanimit me shkollat, mungesa e dokumentacionit apo vështirësia për t’u rikthyer në shkollë pas disa vitesh braktisje, ka vështirësuar këtë proces”.


Frekuentimi i arsimit nga fëmijët romë dhe egjiptianë është i ulët dhe shoqëruar me shumë probleme, ku ndër 150 të intervistuar, 69 % e tyre deklarojnë se ka braktisje të shkollës nga fëmijët e tyre (shih grafikun 4 në vijim). Nga fokus grupet dhe intervistat rezulton se nga fëmijët e komunitetit Rom që banojnë në Breg të Lumit, NjA nr. 4, ka një braktisje të lartë dhe mosfrekuentim të rregullt; fenomeni i mosfrekuentimit vërehet edhe tek Siri Kodra, Sharrë, Bregu lumit NjA nr. 8, Grumbullimi, Nënstacioni Elektrik, Shkozë, Yzberisht etj. Të intervistuarit deklarojnë se ka shumë vajza që braktisin shkollën për shkak se prindërit i martojnë ato në moshë vogël, duke i privuar nga e drejta e shkollimit, si dhe nga mundësia e punësimit në të ardhmen. Sipas studimit⁴⁸ 13.9% e romëve dhe 9.2% e egjiptianeve kanë braktisur shkollën.

46. UNDP, Banka Botërore dhe KE. 2012. Romët në Shqipëri. <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Roma%20in%20%20Albania%20June%202012%20profile.pdf>, aksesuar më 24.05.2017

47. Plani Kombëtar i Veprimit “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge 2015-2017”, Raporti vjetor korrik 2015 – qershor 2016

48. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezí, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane

Grafik. 4 Perceptimet mbi braktisjen e shkollës



Sipas INSTAT⁴⁹, braktisja është e rrallë përpara moshës 10 vjeç (më pak se 3%), por është më e konsiderueshme për moshën 10 deri në 16 vjeç - ajo arrin 30% për djemtë dhe 44.6% për vajzat. Në moshën 16 vjeç, 96% e vajzave dhe 68% e djemve e kanë braktisur shkollën. Në vitin shkollor 2016-2017, sipas të dhënave të marra nga drejtoritë arsimore, 15.2% e fëmijëve romë dhe egjiptianë kanë braktisur shkollën; nga këto 24.2% romë dhe 1.3% egjiptianë. Siç shihet fenomeni i braktisjes së shkollës është shumë i lartë nga fëmijët e komunitetit Rom. Ndër shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës të intervistuarit evidentojnë pamundësinë për të ndjekur shkollën; nevojës për të mbështetur prindërit për të fituar para për jetesën; qëndrimet diskriminuese; rezultatet e dobëta në mësim, probleme me gjuhën shqipe etj. Sipas të dhënave nga Bashkia⁵⁰ në vitin 2016-2017, në 39 shkolla 9-vjeçare ndjekin arsimin bazë 609 fëmijë romë, në 28 kopshte ndjekin arsimin parashkollor 218 fëmijë romë, dhe në 14 shkolla ndjekin arsimin e mesëm 83 nxënës romë.

Nga intervistat evidentohet se: mësuesit sillen shumë mirë me fëmijët; mësuesit janë të mirë dhe të komunikueshëm; janë të dashur dhe

49. INSTAT, Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Profili social-demografik dhe ekonomik bazuar në Censusin 2011, Prill 2015

50. Të dhëna nga Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore dhe Shëndetësore

shumë të sjellshëm, por ka edhe raste kur mësuesit shfaqin diskriminim të fshehur ndaj fëmijëve; nuk i trajtojnë fëmijët njëllor apo ka raste diskriminimi kur fëmijët janë me ngjyrë ose të papastër, edhe kur kanë qenë të papërgatitur. Nuk ka mësues të kualifikuar me origjinë rome në arsimin parashkollor dhe arsimin bazë, në kurrikulën e trajnimit të mësuesve nuk i kushtohet vëmendje romëve si pjesë integrale e historisë dhe kulturës shqiptare. Përmirësimi i cilësisë së edukimit të fëmijëve romë nënkupton përfshirjen e kulturës dhe historisë rome në kurrikulën bazë.

Pavarësisht lëvizjes së shpeshtë, nivelit të ulët arsimor dhe vështirësive të shumta me të cilat janë përballur ndër vite komuniteti Rom dhe Egjiptian, ata kanë ditur të ruajnë dhe të transmetojnë një kulturë dhe traditë të pasur. Gjuha me dialektet e ndryshme, stili komunitar i jetesës dhe solidariteti i theksuar, zakonet, muzika, veshjet dhe kërcimi tradicional, piktura, poezia, janë vlera të mëdha që duhet të njihen, pranohen dhe të zhvillohen. Në punimet artizanale me dorë si të metalit, qëndisjes dhe gdhendjes së bizhuterive, punimeve me kashtë, romët dhe egjiptianët demonstrojnë një traditë dhe talent të madh. Shkollat qendër komunitare duhet të shërbejnë si qendra të rëndësishme të njohjes, promovimit të vlerave dhe talenteve, si dhe të dialogut ndërkulturor. Konkursset për historinë dhe kulturën rome dhe egjiptiane, ekspozitat, panairët, festivalet, mbeten instrumenta të rëndësishëm të njohjes dhe të promovimit. Hapja e kurseve të trajnimeve për punimet artizanale të udhëhequr nga romë dhe egjiptianë mund të jetë një mënyrë për të promovuar integrimin e tyre dhe për të mësuar nga talenti i tyre.

Në dy vitet e fundit Bashkia i ka kushtuar një rëndësi të veçantë përmirësimit të infrastrukturës Arsimore. Vitet 2015-2016 mund të quhen vite të çerdheve dhe kopshteve, u ndërtuan dhe rikonstruktuan 31 çerdhe dhe 27 kopshte. Gjithashtu gjatë këtyre viteve Bashkia u

përqëndrua edhe në ndërtimin e shkollave të reja, rikonstruksionin e atyre ekzistuese, rehabilitimin dhe instalimin e sistemit të ngrohjes, ndërtimin dhe rikonstruksionin e terreneve sportive, etj. Gjatë viteve 2013-2016 janë zbatuar 26 projekte për përmirësimin e shkollave. Një numër i konsiderueshëm nxënësish romë dhe egjiptianë janë përfitues si: 62 nxënës që ndjekin shkollën 9-vjeçare “Gjon Buzuku” përfituan nga rehabilitimi dhe instalimi i sistemit të ngrohjes, po kështu 14 nxënës në shkollën 9-vjeçare “4 Dëshmorët”, 6 nxënës në shkollën 9-vjeçare “Sinan Tafaj”, dhe 5 nxënës në shkollën 9-vjeçare “1 Maji”. Gjatë vitit 2017 në fokus janë shkollat, tre shkolla të reja janë në ndërtim, dhe pritet që shumë shpejt të nisë edhe ndërtimi i 17 shkollave të tjera për t’i dhënë fund mësimit me dy turne, por edhe për të rritur cilësinë e mësimdhënies në institucionet e dijes⁵¹.

Në mënyrë të përmbledhur evidentohet se kemi të bëjmë me nivel të ulët të arsimit të popullsisë rome dhe egjiptiane, me shkallë të ulët të fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin parashkollor, me mungesë të planeve të veprimit “Çdo fëmijë rom në kopsht”, me shkallë të ulët të fëmijëve romë të regjistruar në arsimin bazë, me nivel të lartë të braktisjes së shkollës, me mungesë të instrumentave të përshtashëm për monitorimin e vijueshmërisë në shkolla dhe kopshte, me nivel të ulët të informimit dhe të ndërgjegjësimit të prindërve për domosdoshmërinë e edukimit të fëmijëve, me mungesë të skemave lehtësuese, mbështetëse dhe stimuluese për prindërit dhe fëmijët për të ndjekur arsimin.

Punësimi dhe Arsimi e Formimi Profesional (AFP)

Niveli i lartë i papunësisë, informaliteti ekstrem, të ardhura të pakta nga puna që bëjnë dhe të pamjaftueshme për të siguruar minimumin jetik, pasiguria ose paqëndrueshmëria e vendit të punës, nivel i ulët

51. <http://www.tirana.al/viti-i-ndertimit-te-20-shkollave-ne-tirane-perurohet-shkolla-luigj-gurakuqi-per-femijet-me-aftesi-te-vecanta/>, aksesuar më 12.06.2017

kualifikimi, diskriminimi, nivel i lartë inaktiviteti, mosregjistrimi në zyrën e punës si punëkërkues të papunë, mungesa e besimit te programet e punësimit janë vetëm disa nga problemet e shumta me të cilët ndeshen romët dhe egjiptianët në tregun e punës.

Nuk ka të dhëna të sakta rreth nivelit të punësimit, të pjesëmarrjes ose të shkallës së papunësisë për romët dhe egjiptianët⁵². Sipas Censurit⁵³, në nivel vendi, 74% e romëve të rritur në moshë pune deklarohen të papunë- kjo është shifër mjaft e lartë krahasuar me shifrën zyrtare të papunësisë në popullatën e përgjithshme, e cila është rreth 15% sipas INSTAT. Në Tiranë, po sipas Censurit, 51% e romëve të moshës 18-65 vjeç pohojnë se nuk punojnë. Nga 146 të intervistuar, 13% e vlerësojnë shumë keq, dhe 53% keq gjendjen e përgjithshme të punësimit për komunitetin tyre. Të dhënat e studimit⁵⁴ tregojnë se 24% e romëve dhe 26% e egjiptianëve në moshë pune punojnë, ndërsa 28% e romëve dhe 19% e egjiptianëve punojnë me raste. Po sipas të njëjtit studim, në Tiranë 47% e romëve dhe 56.2% e egjiptianëve janë të papunë, në aspektin gjinor 58.8% e femrave rome dhe 72% e femrave egjiptiane janë të papuna. Romët e anketuar⁵⁵ raportojnë tre arsye kryesore: nuk ka vende të mjaftueshme pune për të gjithë (50%), niveli i ulët arsimor (19.2%) dhe nga fakti që janë romë (16.4%). Shkaqet e papunësisë sipas studimit⁵⁶, romët dhe egjiptianët i lidhin me mungesën e mundësive të punësimit, niveli i ulët arsimor, diskriminimin për shkak të etnisë, dhe me mungesën e aftësive profesionale. Nga 123 të intervistuar, 65% deklarojnë se nuk janë regjistruar në zyrën e punës si punëkërkues të papunë dhe ndër shkaqet, pse jo, ato pohojnë: nuk kam shkuar, ka shumë procedura/ s'ka punë për ne/ nuk ka punë/ nuk kam informacion.

52. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 datë 23.12.2015

53. OSFA, Censuri për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

54. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane.

55. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

56. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Sipas të dhënave të studimit⁵⁷, 36% e romëve dhe 46% e egjiptianëve kërkojnë punë nëpërmjet zyrave të punës- kjo tregon një nivel të ulët besimi të romëve dhe egjiptianëve ndaj zyrave të punësimit. Sipas UNDP⁵⁸ përqindja e të papunëve romë të regjistruar në zyrat e punës është shumë e ulët (20.7%), krahasuar me të papunët e paregjistruar (78.7%). Pak më ndryshe janë shifrat për egjiptianët, ku 56.9% raportojnë se nuk janë të regjistruar, kundrejt 29.9% të regjistruar. Sipas të dhënave⁵⁹ në vitin 2015 janë regjistruar si punëkërkuar në total 2,440 persona dhe janë punësuar 50; në 2016 janë regjistruar 864 dhe punësuar 105, në periudhën Janar-Mars 2017 janë regjistruar 917 dhe punësuar 20, por këtyre të dhënave ju mungojnë ato për romët dhe egjiptianët. Ndërkohë sipas të dhënave "Open Data" në Bashkinë Tiranë janë 728 punëkërkuar në total për vitin 2016, dhe nga këto 150 janë romë dhe 47 janë egjiptian⁶⁰. Numri i studentëve përfitues nga programi i internshipeve⁶¹ (programi IS/ESERE) për vitin 2016-2017 është 22.

Romët janë përfshirë kryesisht në dy aktivitete kryesore, në mbledhjen/grumbullimin e mbetjeve të riciklueshme (mbetjeve metalike, kanaçe alumini, bateri makinash, pajisje elektrike e elektronike, letër karton, qese, shishe apo bidona plastike, mobileri të përdorura, etj.) dhe në shitjen e rrobave të përdorura⁶². Sipas studimit të UNDP⁶³, 40.7% e romëve që punojnë merren me tregtinë e rrobave të përdorura, dhe 42% me grumbullimin e hekurishteve dhe kanaçeve. Sipas një studimi tjetër⁶⁴, 2/3 e romëve punojnë në riciklim dhe shitjen e rrobave të përdorura.

57. Po aty.

58. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

59. Të dhëna nga Drejtoria Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë.

60. [61. <http://romaversitasalbania.org/intership-scheme/>, aksuar më 21.06.2017](http://opendata.tirana.al/?q=dataset/pun%C3%ABsimi/resource/27c1743f-9f3d-4eb7-8af7-c389691ead44#(view-graph:{graphOptions:{hooks:{processOffset: {},bindEvents: {}}},graphOptions:{hooks:{processOffset: {},bindEvents: {}}}}, aksuar më 21.06.2017</p></div><div data-bbox=)

62. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezhi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane

63. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

64. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezhi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane

Vendet kryesore të tregtimit janë pranë mbikalimit të Unazës së madhe me rrugën e Kavajës, në afërsi me shkollën Hoteleri-Turizëm, pranë urës përballë me Pallatin me Shigjeta, përballë Farmacisë 10, pranë Poliklinikës nr. 7 në Laprakë, tek Universiteti Bujqësor, pranë Shkollës së Bashkuar, rruga “Metush Luli”, në rrugën “Vath Koreshi” në Nj. Administrative nr. 1, pranë Stacionit të Trenit, dhe 450 tregtarët që ishin pranë spitalit Nr. 5 (ish-fusha e Beksave) të zhvendosur tek “ish-Uzina Dinamo”. Ndërsa egjiptianët, po sipas të njëjtit studim, janë të angazhuar në shërbime (20.7%), perkujdesja shtëpiake (12%) dhe ndërtimi (10.8%), dhe një shumicë prej 49% shprehen se bëjnë punë ‘tjetër’. Format e punësimit të egjiptianëve janë më të diversifikuara citohet në studim⁶⁵. Disa nga të intervistuarit pyetjes nëse nuk jeni i punësuar, ju lutem a mund të na thoni si e siguroni jetesën? ato ju përgjigjen duke mbledhur mjete të riciklueshme/ me anë të lypjes/ shesim punime artizanale/ gjejmë punë me raste/ ndihmë ekonomike.

Në Tiranë, sipas Censurit⁶⁶ të ardhurat mujore familjare paraqiten shumë të ulëta krahasuar me pagën minimale (69.5% vetëdeklarojnë të ardhura poshtë 20 mijë lekë, 14.6% me të ardhura mes 20-30 mijë dhe vetëm 5.2% mbi 50 mijë lekë). Nga 150 të intervistuar, 67% përgjigjen se të ardhurat e siguruara nga punësimi janë të pamjaftueshme për të përballuar jetesën e përditshme (shih grafikun 5 në vijim). Sipas planit kombëtar⁶⁷, sektorët informal si psh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo aktivitetet e tjera që nuk kërkojnë trajnim të specializuar, gjenerojnë të ardhura më të larta krahasuar me pagën mujore minimale në sektorët formalë.


65. Po aty

66. OSFA, Censuri për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014


67. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 datë 23.12.2015

Ndërkohë nga 135 të intervistuar, 72% pohojnë se nuk kanë një punë të vazhdueshme (shih grafikun 6 në vijim), ndërkohë sipas studimit të UNDP⁶⁸ 50.3% e romëve dhe 57.6% e egjiptianëve të anketuar pohojnë se nuk kanë punuar gjatë shtatë ditëve të fundit.

Grafik 5. Të ardhurat nga punësimi



Grafik. 6 Punë e vazhdueshme



Pesë shkolla profesionale publike⁶⁹ në Bashkinë e Tiranës ofrojnë kualifikime dhe aftësi profesionale për hoteleri-turizëm, automekanik, hidraulik, ndërtim, mobileri, konfeksione, topografi, teknologji informacioni dhe ekonomi. Nuk

68. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri
69. http://www.vet.al/shkollat_arsimit_profesional/publike

ka të dhëna të sakta për numrin e të rinjve romë që ndjekin shkollat e arsimit profesional, mendohet se numri i tyre është pothuajse i pakonsiderueshëm.

Hermann Gmeiner
Hoteleri-Turizëm, Tiranë
Ndërtimit, Karl Gega, Tiranë
Teknike ekonomike, Tiranë
Teknike elektrike Gjergj Canco, Tiranë

Në Tiranë ushtrojnë aktivitetin dy Qendra të Formimit Profesional (nr 1 dhe 4), në vartësi të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. Ato nëpërmjet dhjetra kurseve kontribuojnë në përgatitjen e punëtorëve dhe zanatçinjeve profesionistë për tregun e punës. Nga 149 të intervistuar, vetëm 19% pohojnë se kanë ndjekur kurse të formimit profesional, kundrejt 80% që pohojnë se nuk kanë ndjekur kurse. Ndërsa pyetjes “po anëtarë të tjerë të komunitetit tuaj, a kanë ndjekur kurse profesionale?” 45% pohojnë se kanë ndjekur kurse profesionale, 28% jo dhe 26% nuk e di. Në fokus grupe deklarohet “Nuk kemi informacion për kurset profesionale apo mundësitë që ofrojnë organizatat e ndryshme për komunitetin tonë”. Pyetjes “cili është mendimi juaj për këto kurse, a e lehtësojnë punësimin e anëtarëve të komunitetit tuaj?” 72% përgjigjen se e lehtësojnë, 16% shprehen se jo, dhe 12% me nuk e di. Sipas studimit të UNDP⁷⁰, 86.1% raportojnë se nuk kanë përfituar nga trajnimet profesionale pa pagesë, kurse 13.1% thonë se kanë përfituar. Shumica e të anketuarve (64.6%) thonë se arsyeja kryesore që nuk kanë përfituar është ‘mungesa e informacionit’, kurse dy arsytet e tjera kryesore janë se ‘nuk janë të regjistruar si të papunë’ (14.5%) dhe se ‘nuk besojnë se kjo do të ndihmojë në punësimin’ e tyre (10.7%).

70. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

Për nxitjen e punësimit qeveria ka ngritur pesë programe punësimi të cilët janë të dobishëm dhe të shfrytëzueshëm edhe nga komuniteti Rom dhe Egjiptian si programi i nxitjes së punësimit (i) të punëkërkuësve të papunë nga grupet e veçanta, (ii) formimit në punë, (iii) të grave dhe vajzave nga grupet e veçanta, (iv) të punëkërkuësve të papunë të rinj, (v) të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit. Një vëmendje të veçantë qeveria i ka kushtuar edukimit dhe formimit profesional. Çdo person që kërkon punë ose punë të re, mund të drejtohet për punë dhe për përgatitje për punë në zyrën përkatëse të punësimit ose, me lejen e saj, edhe në ndonjë zyrë tjetër punësimi.

Në mënyrë të përmbledhur evidentohet se kemi të bëjmë me shkallë të lartë papunësie, me shkallë të ulët informimi dhe ndërgjegjësimi rreth përfitimeve dhe rëndësisë së regjistrimit në zyrën e punës si punëkërkuës i papunë, mungesës së koordinimit mes strukturave që punojnë drejtëpërdrejt në komunitet, mungesës së promovimit të iniciativave të vetëpunësimit, mungesës së mbështetjes së bizneseve/ndërmarrjeve sociale që kanë në target punësimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian, mungesës së promovimit të kapitalit social të romëve dhe aftësive të veçanta artizanale, nivelin jo në shkallën e duhur të kapaciteteve të punonjësve dhe strukturave që punojnë drejtëpërdrejt në komunitet.

Kujdesi shëndetësor

Në Bashkinë e Tiranës ushtrojnë aktivitetin 3 qendra specialitetesh dhe 28 qendra shëndetësore⁷¹, si dhe disa pika të tjera ambulatorie që i ofrojnë popullsisë shërbimet shëndetësore të promocionit, parandalimit, diagnostikimit dhe kurimit. Shërbimet shëndetësore për romët dhe egjiptianët mbulohe nga 19 qendra shëndetësore⁷².

71. Urdhëri Nr 28, datë 26.01.2016 Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik

72. UNICEF, CRCA, YWCA dhe OCR, Aksesit i fëmijëve rom në shërbimet e fëmijërisë së hershme në Shqipëri

Qendrat shëndetësore janë njësi bazë e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor. Nga pikëpamja administrative, ato varen nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal⁷³ dhe financiarisht nga Drejtoria Rajonale e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor. Çdo banor takimin e parë e merr në qendrën shëndetësore pranë së cilës është regjistruar nëpërmjet mjekut të familjes (të cilin e zgjedh vetë). Nëse mjeku i familjes gjykon qe diagnostikimi apo trajtimi i rastit kërkon konsultë më të specializuar, atëherë e rekomandon për tek specialisti përkatës. Për të gjithë personat e pajisur me kartë shëndeti mjeku specialist ofron shërbimin falas, ndërsa për të tjerët sipas tarifave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë⁷⁴. Bashkia është përgjegjëse për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik⁷⁵.

Megjithëse ka mungesë statistikash dhe analizash në lidhje me gjendjen shëndetësore të romëve, pohohet se treguesit e gjendjes shëndetësore të romëve po përkeqësohen krahasuar me treguesit e shëndetit të popullsisë së përgjithshme të vendit⁷⁶. Romët kanë një incidencë më të lartë sëmundshmërie dhe janë më të prekshëm sidomos ndaj sëmundjeve të transmetueshme⁷⁷. Është e gjithëpranuar se qasja në shërbimet shëndetësore të komunitetit Rom dhe Egjiptian është e shoqëruar më një seri problemesh dhe sfidash. Varfëria, kushtet e vështira të jetesës, pamundësia për të paguar për shërbimet dhe mjekimet, diskriminimi i hapur ose i fshehur, traditat dhe kultura e romëve

73. Vendimi KM Nr. 394, datë 27.07.2000 Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shëndetësor Rajonal të Tiranës

74. Urdhëri Nr 28, datë 26.01.2016 Për sistemin e referimit dhe tarifave të shërbimit shëndetësor publik

75. Neni 23 (13) Ligji Nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore

76. http://www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/draft_strategjia/Draft_Strategjia_30Maj2016_web.pdf, aksesuar më 19.06.2017

77. Po aty

dhe egjiptianëve (martesat dhe lindjet e hershme), niveli i ulët arsimor, mungesa e informacionit dhe njohurive rreth shëndetit riprodhues, shtatzanisë, sëmundjeve infektive dhe seksualisht të transmetueshme, lindjeve dhe kujdesit për fëmijët, ndryshimet e shpeshta të vendbanimeve, punët me risk të madh shëndetësor, kequshqyrja, trajtimi jo i mirë nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, mungesa e kapaciteteve të personelit mjekësor, etj., përbëjnë shkaqet kryesore të qasjes së vështirë në shërbimet shëndetësore të komunitetit Rom dhe Egjiptian.


Nga 149 të intervistuar, 2% e vlerësojnë shumë keq, 23% keq, 48% mesatar, 22% mirë dhe 5% shumë mirë gjendjen shëndetësore në komunitetin e tyre. Në vitin 2011 nga një vlerësim i QSHMK⁷⁸, 38% e fëmijëve u vlerësuan me vonesa të dukshme zhvillimi në më shumë se dy fusha; në të njëjtin vlerësim evidentohet se njohuritë dhe aftësitë e nënave për të ndihmuar në zhvillimin e gjuhës dhe zhvillimit mendor të fëmijës janë shumë të pakta. Struktura e moshës pasqyron nivelin e lartë të fertilitetit dhe shkallët e larta të vdekshmërisë për të dyja këto grupe: moshë mesatare është 26 vjeç për romët, 29 vjeç për egjiptianët dhe 35.5 vjeç për shqiptarët⁷⁹.

Nga 148 të intervistuar, 2% e vlerësojnë shumë keq, 16% keq, 42% mesatar cilësinë e shërbimeve shëndetësore që ofrohet në zonën e tyre (më në detaje shih grafikun 7 në vijim). Ndër shkaqet që pohojnë të intervistuarit janë: nuk na do njeri/ në disa qendra shëndetësore nuk të ofrojnë shërbim sepse mendojnë që jemi të pisët/ komuniteti nuk ka karta shëndeti dhe nuk mund të marrë shërbime/ nuk dimë kë kemi mjek, aq shumë "interesohe" për ne/ po sëmuremi këtu, asnjë shërbim.

78. Qendra e Shëndetit dhe Mirëqenies Komunitare (QSHMK), Vizitat në shtëpi për promovimin e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve romë në Tiranë dhe Durrës


79. INSTAT, Romët dhe egjiptianët në Shqipëri: Profili social-demografik dhe ekonomik bazuar në Censusin 2011

Grafik 7. Perceptimi mbi cilësinë e shërbimeve shëndetësore



Popullata rome ka njohuri më të ulëta shëndetësore dhe akses më të ulët në shërbimet shëndetësore bazë⁸⁰. Nga 149 të intervistuar, 3% e vlerësojnë shumë keq, 23% keq, 54% mesatar, 15% mirë dhe 3% shumë mirë mundësinë që ka komuniteti i tyre për t'i përdorur shërbimet shëndetësore. Ndër shkaqet që pohojnë të intervistuarit janë: nuk jemi të informuar mirë dhe nuk dinë ku të shkojnë/ na ofendojnë dhe na heqin qafe shpejt/ shumica nuk kanë karta shëndeti/ mundësi kemi por nuk i vlerësojnë/ disa. Sjellja e stafit shëndetësor në QSH ndaj komunitetit Rom dhe Egjiptian vlerësohet 57% mesatar dhe 28% mirë (më në detaje shih grafikun 8 në vijim).

Grafik 8. Perceptimi mbi sjelljen e stafit shëndetësor



80. Plani i veprimit të promovimit të shëndetësor 2017-2021

Rreth 38% e të intervistuarve pohojnë se anëtarët e familjes së tij nuk janë të pajisur me kartë shëndeti, kundrejt 60% që pohojnë se kanë librezë. Sipas studimit të UNDP⁸¹ ka shumë romë (37%) dhe egjiptianë (20%) që nuk dinë ku ta marrin librezën shëndetësore dhe nuk i njohin procedurat. Gjithashtu po sipas të njëjtit studim, rreth 40% e romëve dhe 35% e egjiptianëve vlerësojnë se edhe sikur të kenë librezë shëndetësore, përsëri duhet të paguajnë; rreth 83% e romëve dhe egjiptianëve të anketuar theksojnë se ata paguajnë nën dorë për shërbimet shëndetësore në qendrat shëndetësore dhe në spitalet publike. Vaksinimi është një shërbim i ofruar falas për të gjithë popullatën, përfshirë edhe fëmijët romë dhe egjiptianë. Migrimi i familjeve rome dhe egjiptiane, mungesa e edukimit dhe mosnjohja e pasojave që vijnë nga mosvaksinimi, ekzistenca e frikës tek prindërit romë dhe egjiptianë për efektet anësore që mund të japin vaksinat, kanë sjellë rezistencë për mosvaksinim të fëmijëve, mos respektim të kalendarit/radhës së vaksinimit, dhe më e keqja ekzistencën e fëmijëve të pavaksinuar asnjëherë. Në nivel vendi rreth 11% e fëmijëve romë nuk kanë marrë asnjë vaksinë⁸². Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) bën depistim të zonave ku jetojnë familjet rome dhe egjiptiane për të identifikuar fëmijët e pavaksinuar. Gjatë vitit 2014, ISHP ndërmori iniciativën për të mbuluar më shumë se 95% të çdo komuniteti Rom dhe Egjiptian⁸³.

Gjatë viteve të fundit nga institucionet publike, donatorë të ndryshëm dhe aktorë të shoqërisë civile kanë shtuar përpjekjet për të përmirësuar aksesin e romëve dhe egjiptianëve në shërbimet shëndetësore. Organizata “Save dhe Children”, në partneritet me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Bashkinë e Tiranës⁸⁴, në fund të 2016

81. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

82. UNICEF, CRCA, YWCA dhe OCR, Aksesin e fëmijëve romë në shërbimet e fëmijërisë së hershme në Shqipëri

83. ACFC/SR/IV(2016)005-Raporti i katërt, paraqitur nga Republika e Shqipërisë, mbështetur në Nenin 25, paragrafi 2, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare

84. <http://www.shendetesia.gov.al/al/newsroom/lajme/qender-e-re-shendetesore-per-10-mije-banoret-e-alliasit>, aksesuar më 16.06.2017

Komunitetet Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Tiranë

kanë mundësi të barabarta dhe gjithëpërfshirëse nëpërmjet aksesit të përmirësuar në të gjitha shërbimet publike, me prioritet shërbimet e gjendjes civile dhe drejtësisë, në edukim dhe kujdes shëndetësor. Romët dhe egjiptianët përfitojnë më shumë nga programet e strehimit dhe mbrojtjes sociale, me kushte më të mira jetese nëpërmjet mundësive për punësim dhe punë të denjë, si dhe duke bashkëjetuar në komunitete më të fuqizuara lokale.

bëri të mundur ngritjen dhe pajisjen e qendrës së re shëndetësore Allias e cila ju shërben 10.000 banorëve. Kjo organizatë në Allias ka realizuar fushata edukuese me gratë rome për të rritur njohuritë dhe praktikën mbi ushqyerjen e fëmijëve 0-5 vjeç, si dhe ndërgjegjësimin mbi kujdesin që duhet të tregojnë gratë gjatë shtatzanisë dhe pas saj. Ndërkohë në zonën e Kinostudios dhe Shkozës, gjatë viteve 2013-2014, ka organizuar sesione informative javore lidhur me aksesin ndaj shërbimeve shëndetësore⁸⁵, si dhe kujdesin gjatë shtatzanisë. Me mbështetjen e UNICEF në vitin 2011-2012 u zbatua projekti “Vizita në shtëpi për promovimin e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve romë në Tiranë dhe Durrës”. Qendra e Shëndetit dhe Mirëqenies Komunitare (QSHMK), me mbështetjen e UNICEF, ka përgatitur manualin që do të përdoret gjatë vizitave në shtëpi, si dhe listat e kontrollit që do të plotësohen për çdo fëmijë të vizituar⁸⁶. Organizata “Disutni Albania” nëpërmjet një projekti në Tiranë synon ndërgjegjësimin e romëve dhe egjiptianëve për kartën e shëndetit ndërkohë shoqata Sfinksi (Sfinksi Association) po punon për identifikimin e njerëzve pa kartë shëndeti dhe informimin mbi çështjet e lidhura me shëndetin. Në Shkurt 2014, Ministria e Shëndetësisë ka mbështetur propozimin e Vodafone Albania Foundation për përfshirjen e komunitetit Rom në projektin për kontrollin bazë mjekësor, përmes përdorimit të teknikave mjekësore të telemedicinës⁸⁷.

Në sesionin strategjizues⁸⁸ u evidentua se bashkëpunimi qendër shëndetësore- komunitet nuk është në nivelin e duhur, nuk janë ngritur mediatorët e shëndetit, kapacitetet e personelit mjekësor (infermieret e terrenit) që mbulojnë komunitetin Rom dhe Egjiptian duhet të

85. ACFC/SR/IV(2016)005-Raporti i katërt, paraqitur nga Republika e Shqipërisë, mbështetur në Nenin 25, paragrafi 2, të Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare,

86. www.shendetesia.gov.al/files/userfiles/Integrimi/d4.doc

87. Kontributi i Ministrisë së Shëndetësisë për Nënkomitetin “Tregu i brendshëm dhe Konkurenca” Bruksel, 5 Mars 2015.

88. Sesioni Strategjizues me Grupin e Planit të Zhvillimit Lokal të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, 12 Maj 2017

përmirësohen. Lëvizjet e shpeshta apo shtegtimet krijojnë vështirësi të mëdha për vaksinimin, për kujdesin ndaj fëmijëve të sapolindur dhe nënave shtatzëna.

Në mënyrë të përmbledhur evidentohet se kemi të bëjmë me akses të ulët në shërbimet shëndetësore, mungesë statistikash të organizuara në lidhje me gjendjen shëndetësore të romëve dhe egjiptianëve, kapaciteteve të personelit mjekësor (infirmieret e terrenit) që mbulojnë komunitetin Rom dhe Egjiptian jo në nivelin e duhur, mungesë informacioni dhe njohurish rreth shëndetit riprodhues, shtatzanisë, sëmundjeve infektive dhe seksualisht të transmetueshme, lindjeve dhe kujdesit për fëmijët nga anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian, mungesë të njohurive dhe aftësive të nënave për të ndihmuar në zhvillimin e gjuhës dhe zhvillimit mendor të fëmijës, numër të lartë romësh dhe egjiptianësh pa karta shëndeti, mungesë edukimi për pasojat që vijnë nga mosvaksinimi, ekzistencë të fëmijëve romë dhe egjiptianë të pavaksinuar, infrastruktura shëndetësore jo në nivelin e duhur, mungesë të ndërmjetësuesve shëndetësorë në komunitetin Rom dhe Egjiptian.

Strehimi dhe integrimi urban

Plotësimi i nevojave të shtetasve për strehim është një nga objektivat sociale kushtetuese⁸⁹. Për realizimin e këtij objektiivi shteti ka krijuar tre programe sociale strehimi⁹⁰: atë të banesave sociale me qera, të banesave me kosto të ulët dhe të pajisjes së truallit me infrastrukturë, të cilët shërbejnë për strehimin e familjeve dhe të individëve. Shteti gjithashtu ka krijuar gjashtë kategori ndihmash si bonus strehimi, subvencionim të qerasë, subvencionim të interesave të kredisë, grant të menjëhershëm, asistencë teknike dhe grante të vogla për

89. Neni 59 i Kushtetutës

90. Neni 3 i Ligjit Nr.9232, datë 13.05.2004 "Për programet sociale të strehimit"

zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit Rom. Nga këto programe përfitojnë⁹¹ individët mbi 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile të cilat që në momentin e aplikimit nuk kanë në pronësi një banesë, zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit ose kanë mbetur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore, për të tre rastet përfitues janë familjet që kanë të ardhura të pamjaftueshme. Me këtë rast, nga njëra anë, duhet të evidentohet fakti që koncepti i ardhurave të pamjaftueshme është i lidhur me atë që individët dhe familjet nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore dhe shteti nëpërmjet programeve ju krijon mundësi për strehim të përshtatshëm e të përballueshëm, dhe nga ana tjetër përballemi me faktin që programet sociale të strehimit kanë si bazë dhe mbështeten në aftësitë paguese të familjeve duke krijuar kështu përjashtimin e të varfërve nga programet. Fakti që programet sociale të strehimit tërheqin familjet me të ardhura mesatare 6 deri në 8 herë më të larta se niveli i varfërisë është një nga gjetjet e raportit⁹² të UNDP. Më të varfërit e të varfërve nuk i plotësojnë kriteret për programet e strehimit social, pohohet në Strategjinë e

Strehimit Social⁹³. Bashkia është përgjegjëse⁹⁴ për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave për strehim, administrimin e kërkesave, caktimin e përparësive, përzgjedhjen e përfituesve, krijimin dhe administrimin e bazës së të dhënave për familjet që përfitojnë strehim, hartimin e programit 10-vjeçar dhe projektit tre-vjeçar për strehimin bazuar në burimet, sigurimin e shesheve të ndërtimit dhe pajisjen e truallit me infrastrukturë, ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin⁹⁵, sigurimin e transparencës (informacion për llojin e programit, kushtet,

91. Neni 4, po aty

92. Strehimi social në Shqipëri: Vlerësim i nevojave, Gusht 2014

93. Vendim i KM Nr 405, datë 01.06.2016 Për Miratimin e Strategjisë së Strehimit Social 2016-2025

94. Ligji Nr.9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale të strehimit"

95. Neni 24 (2) i Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

dokumentacionin, procedurën dhe transparencën e procesit të përzgjedhjes së përfituesve).

Nga viti 2015 një anëtar në komisionin⁹⁶ e strehimit, pranë Bashkisë së Tiranës është nga Shoqata e Romëve për Integrim dhe Kundër Trafikimit të Fëmijëve. Në sesionin strategjizues⁹⁷ përfaqësues të romëve e vunë në dyshim pjesëmarrjen e një përfaqësuesi rom në komisionin e strehimit, gjithashtu dhe rolin dhe dobinë në përgjegjësi të këtij komisioni. Në vitet e fundit Bashkia i ka kushtuar një vëmendje të veçantë ndërtimit dhe shpërndarjes së banesave sociale. Janë miratuar dy vendime të Këshillit të Bashkisë, vendimi Nr. 28, datë 13.08.2015 nëpërmjet të cilit është miratuar kontigjenti i parë i listës së aplikuesve prej 242 familjeve për të përfituar nga programi i banesave sociale në Shkozë; vendimi Nr. 44, datë 06.07.2016 nëpërmjet të cilit janë miratuar 177 familje përfituese, 104 familje në listë pritje, masa e qerasë mujore, si dhe masa e subvencionit për çdo familje përfituese nga programi i banesave sociale në Shkozë, ish-Fonderia Mekanike.

Sipas Drejtorisë së Strehimit Social nga 01.07.2015 deri më 31.03.2017 kanë aplikuar 919 familje për banesa sociale me qera dhe kanë përfituar 545 familje. Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar prej banesave sociale është rreth 177 (familje) ose 38.8%, nga ku rreth 60% janë romë dhe 40% egjiptianë. Bashkia e Tiranës nga Janari 2017 ka nisur punën për zbatimin e projektit të financuar nga "IADSA", që synon ndërtimin e banesave të reja me qëllim krijimin e kushteve më të mira dhe përmirësimin e jetës sociale të 50 familjeve të komunitetit Rom⁹⁸. Ndërkohë 60 familje të komunitetit Rom që preken nga projekti i rehabilitimit të Lumit të Tiranës në zonën e Bregut të


96. Vendim Nr.62 datë 30.12.2015 Për "Një ndryshim në vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 63, datë 08.11.2005, "Për miratimin e komisionit të strehimit" (i ndryshuar)"

97. Sesioni Strategjizues me Grupin e Planit të Zhvillimit Lokal të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, 12 Maj 2017

98. <http://www.tirana.al/nis-ndertimi-i-banesave-te-reja-per-50-familje-rome-ne-shkoze/>, aksesuar më 22.06.2017

Lumit, do të sistemohen në banesa të reja⁹⁹. Ndër 145 të intervistuar, 18% e vlerësojnë mirë punën që ka bërë Bashkia për komunitetin e tyre, 46% mesatar dhe 12% keq (më në detaje shih grafikun 9 në vijim). Ato shprehen se “na kanë lënë me jetu në rulota, pa ujë, pa gjë, si mos më keq/ Bashkia i nënvlerëson romët/ duhet shumë punë për ne/ rrugët janë të pashtuara dhe nuk ka kanalizime/ sepse gjatë kohës së shirave kanalizimet mbingarkohen dhe krijohen probleme.”

Grafik. 9 Vlerësimi për punën e Bashkisë



Për të adresuar çështjen e strehimit të grupeve të pafavorizuara, të cilët kanë të ardhura të ulëta apo nuk kanë të ardhura fare, Bashkia ka ofruar bonus strehimi nga të ardhurat e veta, për këtë qëllim janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë disa vendime (Shih tabelën 1 në vijim).

99. <http://www.tirana.al/60-banesa-te-reja-sociale-per-400-anetare-te-komunitetit-rom-ne-shkoze/>, aksesuar më 22.06.2017

Tabela. 1 Numri i përfutuesve të bonuseve të strehimit

Vendimi	Nr i përfutuesve	Fondi mujor/lekë	Burimi
Nr.14, datë 06.03.2015	14	118493	Fondi Bonusi i Strehimit
Nr.27, datë 23.05.2016	54	463166	Fondi Bonusi i Strehimit
Nr.65, datë 07.10.2016	59	748684	Fondi Bonusi i Strehimit
Nr.43, datë 06.07.2016	48	517346	Fondi Bonusi i Strehimit
Nr.89, datë 29.12.2016	156	1620760	Fondi Bonusi i Strehimit
Nr. 39, datë 05.04.2017	99	972577	Fondi Bonusi i Strehimit
Nr. 52, datë 06.06.2017	60	697226	Fondi Bonusi i Strehimit

Kushtet e Banimit

Ndër 150 të intervistuar, 25% deklarojnë se kushtet e banimit janë keq, 7% shumë keq, 7% shumë mirë dhe 29% mirë (shih grafikun 10 në vijim). Sipas studimit të UNDP¹⁰⁰, më shumë se 38% e familjeve rome jetojnë në ndërtesa të vjetra të rrënuara dhe 21% jetojnë në baraka të ndërtuara me materiale plastike, panele metalike dhe tenda të improvizuara. Kushtet e mira të jetesës ndër romët mbeten përjashtimi dhe jo rregull. Në përgjithësi, gjendja vazhdon të jetë e rëndë. Një numër i konsiderueshëm i familjeve rome jetojnë në barraka dhe në kushte jo të përshtashme higjieno-sanitare, në hapësira të pamjaftueshme, pa ngrohje, me kufizime e mungesa në furnizimin me ujë të pijshëm, e të banjave dhe kanalizimeve. Sipas të njëjtit studim¹⁰¹, afërsisht 38.8% e popullsisë rome nuk kanë ujë të rrjedhshëm brenda banesës, 43.3% nuk kanë banjë në shtëpi, 43.3% nuk janë të lidhur me rrjetin e ujërave të zeza. Mungesa e ujit dhe kanalizimeve është burimi kryesor i sëmundjeve infektive dhe përqindjes së lartë të vdekshmërisë tek fëmijët. Në lidhje me banueshmërinë e godinës sipas Censurit¹⁰²

100. Politikat dhe Praktikrat e Strehimit të Romëve në Shqipëri, Shtator 2013


101. Po aty

102. OSFA, Censuri për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

nga 855 familje të intervistuar 43.5% prej tyre deklarojnë godinën të pabanueshme, 19.4% pothuajse e pabanueshme, 19.2% pothuajse e banueshme dhe vetëm 17.9% e deklarojnë godinën të banueshme. Një nga instrumentat për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit Rom janë grantet e vogla¹⁰³, këto përdoren për përshtatje të strehave/banesave të improvizuara (vendosje dritarësh, dyerësh, çatie, etj.), për përmirësimin e furnizimit me ujë të pijshëm, për përmirësimin e kushteve higjeno-sanitare (dushe, banjo, kanalizime, etj.).

Në vitet e fundit nga buxheti i shtetit nuk kemi grante të vogla për Bashkinë për përmirësimin e kushteve të banimit, ndërkohë në strategjinë e strehimit¹⁰⁴ është planifikuar të përfitojnë 150 familje rome dhe egjiptiane nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit gjatë periudhës 2016-2019 në rang vendi.

Grafik. 10 Perceptimi mbi kushtet e banimit




103. Neni 25/2 i Ligjit Nr.9232, datë 13.05.2004 "Për programet sociale të strehimit"

104. Vendim i KM Nr. 405, datë 01.06.2016 "Për miratimin e strategjisë së strehimit social 2016-2025"

Aksesi në programet sociale të strehimit nga komuniteti Rom është i ulët. Vetëm 3% e të intervistuarve deklarojnë se kanë përfitur ndihmë nga shteti si i pastrehë, ndërkohë 76% deklarojnë se nuk kanë aplikuar ndonjëherë, 15% nuk e njohin këtë skemë ndihme (shih grafikun 11 në vijim). Ndër shkaqet e kësaj gjendje të intervistuarit paraqesin “Nuk plotësojmë kushtet/ nuk kam informacion/ nuk di të aplikoj/ nuk kam aplikuar sepse nuk di ku të drejtohem”. Sipas një studimi¹⁰⁵ të UNDP, një nga arsyt kryesore pse nuk kanë aplikuar për strehim social janë mungesa e informacionit (46.2%); një tjetër arsye e aksesit të ulët është se familjet rome dhe egjiptiane nuk plotësojnë kushtet ligjore. Sikurse u citua më lart programet sociale të strehimit kanë si bazë dhe mbështeten në aftësitë paguese të familjeve, shumica e romëve dhe egjiptianëve janë të varfër dhe nuk kanë aftësi paguese, 97.4% e 855 familje rome të intervistuar në Census¹⁰⁶ 2014 në Bashkinë Tiranë kanë deklaruar se të ardhurat e tyre mujore janë shumë poshtë të ardhurave mesatare familjare për Tiranën.

Grafik.11 Përfitimi nga ndihma si i pastrehë



105. Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri, Tiranë, 29 shkurt 2012

106. OSFA, Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014 (shifra e përlogaritur nga ne për Bashkinë Tiranë)

Një arsye tjetër që duhet vlerësuar është se nga njëra anë kemi një numër të madh dokumentash dhe procedurash që duhen plotësuar e ndjekur me qëllim për të përfituar nga programet sociale, dhe nga ana tjetër kemi një nivel të ulët arsimor dhe mungesën e aftësisë së romëve dhe egjiptianeve për të aplikuar. 51% e romëve¹⁰⁷ nuk dinë të shkruajnë e lexojnë.

Gjendja e Infrastrukturës. Një përqindje e konsiderueshme e të intervistuarve e vlerësojnë gjendjen e infrastrukturës (rrugë/ ujësjellës/ kanalizime) mirë (20%), keq (11%) dhe shumë keq (16%). Romët që banojnë në Siri Kodra, Sharrë, Farkë, Selitë, Bregu i Lumit nuk kanë akses në shërbimet publike (ujë, kanalizime, rrugë). Përfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian në fokus grupe deklarojnë se “Na kanë lënë me jetu në rulota, pa ujë, pa gjë, rrugët janë të pashtuara dhe nuk ka kanalizime, gjatë kohës së shirave kanalizimet mbingarkohen dhe krijohen probleme”. Sipas censusit¹⁰⁸, 16% e familjeve rome nuk kanë akses në ujë të pijshëm të rrjedhshëm as në mjediset e jashtme dhe as në mjediset e brendshme të banesës, 84% e familjeve rome në shkallë vendi nuk kanë akses në ujë të ngrohtë të rrjedhshëm në mjediset e brendshme të banesës.

Familjet rome jetojnë kryesisht në vendbanime informale, në troje që nuk u përkasin atyre ose në toka me pronësi të diskutueshme, në shtëpi pa dokumenta pronësie. Të dhënat për pronësinë janë kontradiktore dhe të paplota: Nga 148 të intervistuar nga IDM, 49% e tyre deklarojnë se banesa ku jetojnë është në pronësi të tyre, ndërkohë nga 854 familje rome të intervistuar, Census¹⁰⁹ 2014, vetëm 22.4% deklarojnë banesën në pronësinë e tyre, ndërsa 25.9% e deklarojnë në pronësi por pa dokumenta, dhe 22.4% në proces legalizimi. Pavarësisht nga të dhënat

107. OSFA, Census 2014-Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri

108. Po aty

109. Po aty

e paplota dhe nganjëherë kontradiktore, mungesa e pronësisë dhe jetesa në vendbanime informale i ka bërë këto komunitete të jenë më të ekspozuar nga zhvendosjet, dëbimet apo të mos kompensimit, si rezultat i ndërtimit të objekteve publike, etj. Zhvendosjet dhe dëbimet shoqërohen me një mori problemesh sociale si mbetja pastrehë, tensione, humbje të punës, probleme me arsimimin e fëmijëve, humbje të lidhjeve shoqërore dhe të lidhjeve me komunitetin. Ka pasur disa raste të zhvendosjes të romëve si rezultat i ndërtimit të objekteve publike, si rasti i Unazës së Re, pa dakordësinë e komunitetit Rom dhe pa pëlqimin e tyre për strehimin alternativ të ofruar. Përfaqësues të komunitetit Rom në fokus grupe dhe në intervista, deklarojnë se asnjëherë nuk ka patur konsultim me komunitetin për projektet që po bëhen dhe që prekin interesin e romëve, por gjithmonë një njoftim dhe zhvendosje me forcë. Ato deklarojnë se “pse kasollet tona të ngritura prej vitesh nuk legalizohen dhe të shpronësohen sipas ligjeve kur ka interesa publike”.

Në mënyrë të përmbledhur evidentohet se kemi të bëjmë me akses të ulët në programet e strehimit social, mungesë informimi për programet sociale të strehimit, mungesë të të dhënave mbi gjendjen dhe nevojat për strehim dhe integrim urban për romët dhe egjiptianët, mungesë të njohurive dhe pamundësi për plotësimin e dokumentave dhe procedurave për strehim, mungesë të granteve të vogla për përmirësimin e kushteve të banimit, kapacitete të administratës publike jo në nivelin e duhur për të kuptuar qasjen e integritit të romëve dhe egjiptianëve në fushën strehim dhe integrim urban, mungesë të fondeve për programin e pajisjes së truallit me infrastrukturë, mungesë të skemave për konsultim me komunitetin Rom dhe Egjiptian, infrastrukturë publike në vendbanimet e komunitetit Rom jo në nivelin e duhur (rrugë, kanalizime, ujë të pijshëm, çerdhe, kopshte, shkolla, furnizimi me energji, etj.), mungesë e një plani strehimi disa vjeçar për romët dhe egjiptianët.

Mbrojtja sociale

Mbrojtja sociale është një nga mekanizmat kryesore për zbutjen e varfërisë e përjashtimit social. Nëpërmjet komponentëve të tillë si të asistencës dhe programeve të mirëqenies sociale, mbrojtjes së fëmijëve, skemave të mbështetura në terren për të adresuar dhe trajtuar nevojat në nivel komunitar, ajo synon të sigurojë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit e përfshirjen sociale.

Komuniteti Rom dhe Egjiptian është nga komunitetet me shkallën më të lartë të varfërisë. Sipas një studimi të UNDP¹¹⁰ rezulton se 77.7% e familjeve rome dhe 84.1% e atyre egjiptiane bëjnë pjesë në grupin “shumë të varfër”, ndërsa 6.1% e romëve dhe 7.8% e egjiptianëve janë të varfër. Shumë pak e përmirësuar paraqitet situata në Tiranë, ku sipas të dhënave të studimit¹¹¹ 67.7% e romëve dhe 75.5% e egjiptianeve kategorizohen shumë të varfër, 16.8% e romëve dhe 10.6% e egjiptianëve të varfër, dhe vetëm 14.8% e romëve dhe 13.9% e egjiptianëve kategorizohen jo të varfër. Ky komunitet karakterizohet (i) nga një nivel i lartë papunësie. Sipas censurit¹¹² në nivel vendi, 74% e romëve të rritur në moshë pune deklarohen të papunë (ii) me të ardhura të pakta. Në Tiranë, sipas Censurit¹¹³, 69.5% vetëdeklarojnë të ardhura poshtë 20 mijë lekë (iii) që punojnë pa kontrata pune, pa sigurime shoqërore dhe në informalitetet ekstrem (iv) me nivel të ulët arsimor, dhe me një nivel të lartë inaktiviteti Gjithashtu ato përjetojnë nivele të larta të përjashtimit social. Ndër problemet kryesore që përballen familjet rome dhe egjiptiane në Tiranë¹¹⁴ janë papunësia (33.1% romët

110. UNDP, Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri

111. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezhi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane.

112. OSFA, Censuri për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri, prill 2014

113. Po aty- të përllogaritur nga ekspertët e këtij plani

114. UNDP, Ilir Gëdeshi, Pavli Mykerezhi, Eriselda Danaj, Hartëzimi i Aftësive, mundësive të punësimit dhe sipërmarrjes së komuniteteve rome dhe egjiptiane

